

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 5977
E enjte, 16 janar 2020
çmimi 0.40 €

Thaçi flet me Borrellin: Kosova ka përmbushur kushtet për vizat



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS
(LDK) I PËRGGJIGJET ME KUNDËROFERTË
LËVIZJES VETËVENDOSJE (LV)

LDK-ja REFUZON OFERTËN E LV-së, KËRKON KRYEPARLAMENTARIN

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka refuzuar ofertën për bashkëqeverisje të Lëvizjes Vetëvendosje për shtim të numrit të ministrive në 14 sosh. Kjo parti të mërkurën i ka nisur një

propozim të ri LV-së që ishte diskutuar më 8 janar në mes të krerëve të dy partive. Përmes këtij propozimi LDK-ja kërkon që ta ketë postin e kryeparlamentarit deri në zgjedhjen e

presidentit, i cili do të jetë kandidat i propozuar nga LDK-ja, ndërsa ndarja e 12 ministrive të jetë ashtu siç janë pajtuar në fillim, 5 me 5. Komitetet pakicë do t'i kenë vetëm dy ministri



OPINION

REÇAKU I 15
JANARIT 1999

F. 11

Muharrem
NITAJ



AKTUALE

NJË PERSON VDES
SI PASOJË E GRIPIT

F. 7

PËRURORHET SALLA E TRETË
OPERATIVE NË KIRURGINJË
VASKULARE

F. 9



EKONOMI

ATK-ja INKASON 33.4 MILIONË
EURO BORSHE MË SHUMË

F. 9

VLERA E MALLRAVE TË LIRUARA
PËR PRODHUES NË IMPORT
PËR VITIN 2019 ËSHTË
370 MILIONË EURO

F. 9

SPORT

HYSENI: ENDE NUK E DI TË
ARDHMEN, OFERTA KAM EDHE
NGA SHQIPËRIA

F. 20



TË MËRKURËN ËSHTË SHËNUAR 21-VJETORI I
MASAKRËS SË REÇAKUT

21 VJET NGA MASAKRA QË NDRYSHOI HISTORINË E KOSOVËS

Të mërkurën u bënë 21 vjet nga dita kur ndodhi masakra e 45 civilëve shqiptarë në fshatin Reçak të Komunës së Shtimes nga forcat policore dhe ushtarake serbe. Liderët e shtetit të Kosovës dhe ata

partiakë kanë bërë homazhe me rastin e 21-vjetorit të masakrës së Reçakut, po ashtu është mbajtur edhe një akademi përkujtimore. Presidenti Hashim Thaçi ka thënë se krimet monstruoze serbe u orkestru-

an nga shteti i Serbisë. Homazhe në Komplexin Përkujtimor në Reçak ka bërë edhe njeriu që doli publikisht para 21 vjetësh duke dhënë alarmin për krimet serbe në Kosovë, Willaim Walker

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Shqipëria dëbon dy diplomatë iranianë

TIRANË, 15 JANAR - Autoritetet në Shqipëri njoftuan të mërkurën se kanë urdhëruar dëbimin e dy diplomatëve iranianë, të cilët janë shpallur persona të padëshiruar.

Vendimi u bë i ditur nga ministri i Jashtëm në detyrë, Gent Cakaj, në një postim në Facebook.

Sipas tij, dy diplomatët: Mohammad Ali Arz Peimanemati dhe Seyed Ahmad Hosseini Alast kanë zhvilluar "veprimtari në

mospërputhje me statusin e tyre dhe parimet e Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike".

"Dy përfaqësuesve të Republikës Islamike të Iranit u është kërkuar largimi i menjëhershëm nga territori i Republikës së Shqipërisë", tha Cakaj.

Kjo është hera e dytë që Shqipëria shpall persona të padëshiruar diplomatë iranianë.

Në dhjetor të vitit 2018, ambasadori i Iranit në Shqipëri dhe një tjetër diplomat i ambasadës u dëbuan nga ky vend, pasi dyshoheshin se ishin përfshirë "në aktivitete që cenojnë sigurinë".

Në atë kohë, Ministria e Jashtëm e Shqipërisë tha se vendimi është marrë në konsultim me vendet aleate, për shkak të aktivitetit të tyre në Shqipëri në kundërshtim me statusin e tyre diplomatik.



HRW: Përparim i ngadalshëm i të drejtave të njeriut në Kosovë

Raporti i Organizatës ndërkombëtare, Human Rights Watch, mbi gjendjen e të drejtave të njeriut e vlerëson të ngadalshëm përparimin në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe përfshin çështjet që kanë të bëjnë me krimet e luftës, kërcënimet dhe frikësimet e gazetarëve, tensionet etnike, gjendjen e pakicave dhe dhunën në familje

PRISHTINË, 15 JANAR - Organizata ndërkombëtare më seli në Nju Jork, Human Rights Watch, publikoi raportin 652 faqesh mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në rreth 100 vende të botës.

Në kapitullin për Kosovën raporti vëren bllokadën e procesit të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë që nga nëntori i vitit 2018.

Raporti përmbledh çështjet që kanë të bëjnë me krimet e luftës, kërcënimet dhe frikësimet e gazetarëve, tensionet etnike, gjendjen e pakicave dhe dhunën në familje.

Në raport përmendet marrja në pyetje e të dyshuarve në Prokurorinë e Posaçme në Hagë, përfshirë edhe atë të kryeministrit në largim të Kosovës Ramush Haradinaj që u pasua me zgjedhjet e parakohshme, dhe fakti se ende nuk është ngritur asnjë akuzë.

Aty përmendet edhe paraburgosja e ish-pjesëtarit të Ushtrisë jugosllave Goran Stanishiq, nën

dyshimet për pjesëmarrje në krimet kundër shqiptarëve në fshatin Slllovinjë, në prill të vitit 1999.

Raporti përfshin dënimin me 14 vjet heqje lirie të ish-pjesëtarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Remzi Shala, nën akuzat për krime lufte kundër popullsisë civile si dhe dënimin e ish-policiit serb Zoran Vukotiq për krime lufte në rrethinën e Mitrovicës në maj të vitit 1999 dhe akuzimin e një serbi tjetër Zoran Gjokiq për përfshirje në vrasjen e 33 shqiptarëve në rajonin e Pejës në prill të vitit 1999.

Raporti vë re se Kombet e Bashkuara nuk kanë kërkuar falje dhe nuk kanë kompensuar viktimat e helmimit, që pas luftës së viteve 1998-1999, janë detyruar të jetojnë në disa kampe në veri të Kosovës, të udhëhequra nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

Viktimat janë pjesëtarë të komuniteteve: rom, ashkali dhe egjiptian, thuhet në raport, sipas të cilit



asnjë përparim konkret nuk është raportuar në integrimin e tyre.

Sipas organizatës "tensionet ndëretnike kanë vazhduar gjatë vitit 2019 sidomos në veriun e Kosovës". Aty përmendet akuzat ndaj ish-ministrit serb Ivan Teodosijević, për nxitje dhe përhapje të urrejtjes, përçarjes dhe jotolerancës si dhe rasti i politikantit lokal serb Oliver Ivanović, i cili u vra në janar të vitit 2018.

Me gjithë disa zhvillime pozitive, dhuna në familje mbetet një problem në Kosovë me një reagim joadekuat të policisë, me pak ndjekje penale dhe dështim të vazhdueshëm të gjyqtarëve për të lëshuar urdhra kufizues ndaj partnerëve abuzues, thuhet në

raport, në të cilin përmendet edhe sukcesi i kufizuar i procesit të mbështetjes së viktimave të përdhunimeve gjatë luftës në Kosovë.

Në muajin qershor, thuhet në raport, rreth 800 të mbijetuar të përdhunimeve kanë aplikuar për këtë mbështetje. Prej tyre janë miratuar 145 kërkesa ndërsa 102 janë refuzuar.

Sipas HRW-së, gjatë dhjetë muajve të parë vitit 2019, janë regjistruar 115 kthime vullnetare të pjesëtarëve të pakicave etnike të zhvendosur nga Kosova, ndërsa periudhën e njëjtë të vitit 2018 ishin regjistruar 153 të kthyer.

Ministria e Brendshme e Kosovës ka regjistruar 800 kthime të detyrueshme kryesisht nga

Gjermania, në periudhën janar-gusht 2019. "Në mesin e të kthyerve me forcë 189 ishin fëmijë. Të kthyerve u është ofruar ndihmë e kufizuar", thuhet në raport.

Kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve kanë vazhduar, ndërsa hetimet dhe ndjekjet penale kanë qenë të ngadalshme, thuhet në raport sipas të cilit, kërcënimet në mediet sociale mbeten shumë të përhapura.

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës ka regjistruar 11 raste të kërcënimit dhe dhunës ndaj gazetarëve ndërmjet muajve janar dhe shtator, thuhet mes tjerash në raport, i cili e vlerëson të ngadalshëm përparimin në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë.

Opozita rinis protestat në shkurt

TIRANË, 15 JANAR - Kolegji i kryetarëve të Partisë Demokratike ka vendosur të mërkurën rikthimin e protestave opozitare.

Në vendimin e drejtuesve të PD-së është përcaktuar muaji shkurt si koha e mbajtjes së një proteste të madhe kombëtare. Mësohet se kërkesa për protes-

ta ka ardhur nga drejtuesit e degëve të PD-së. Datat 20 ose 22 shkurt shihen si mundësia e mbajtjes së tubimit kombëtar. Kujtojmë se ky takim vjen një ditë pas marrëveshjes me maxhorancës për ulje në një tryezë për reformën zgjedhore, kjo e fundit si një nga kushtet e vendosura nga Bundestagu për

çeljen e negociatave.

Baza demokrate dhe krejt partitë opozitare insistojnë se me kryeministrin Rama nuk mund të ketë kurrë marrëveshje, pasi ai mashtron dhe fiton nga pazaret në tavolinë. Demokratët e bazës shpjeguan se duhet përballje me qeverinë Rama.



Të mërkurën është shënuar 21-vjetori i masakrës së Reçakut

21 vjet nga masakra që ndryshoi historinë e Kosovës

Të mërkurën u bënë 21 vjet nga dita kur ndodhi masakra e 45 civilëve shqiptarë në fshatin Reçak të Komunës së Shtimes nga forcat policore dhe ushtarake serbe. Liderët e shtetit të Kosovës dhe ata partiakë kanë bërë homazhe me rastin e 21-vjetorit të masakrës së Reçakut, po ashtu është mbajtur edhe një akademi përkujtimore. Presidenti Hashim Thaçi ka thënë se krimet monstruoze serbe u orkestruan nga shteti i Serbisë. Homazhe në Kompleksin Përkujtimor në Reçak ka bërë edhe njeriu që doli publikisht para 21 vjetësh duke dhënë alarmin për krimet serbe në Kosovë, Willaim Walker



Thaçi ka thënë se si rezultat i mobilizimit ndërkombëtar dhe me qëllim që t'i jepet fund politikës së gjenocidit dhe spastrimit etnik në Kosovë u organizua Konferenca Ndërkombëtare shpejt në Rambuje, në fillim të shkurtit 1999. "Lufta e UÇK-së bëri punën e vet që është e pazëvendësueshme, është heroike, është e shenjtë. Ndiham e NATO-s ishte jetike. Kosova u çlirua, Kosova fitoi lirinë. Por, tërheqja e trupave serbe mundësoi të dilnin në shesh përmasat e gjenocidit të kryer nga shteti i Serbisë kundër shqiptarëve në Kosovë", ka theksuar ai. Sipas presidentit Thaçi, tanimë këtë spastrim etnik, këtë masakra, këtë gjenocid askush nuk mund ta fshihte, nuk mund ta fshilte se u vranë mbi 13 mijë civilë shqiptarë, u dhunuan mbi 20 mijë femra shqiptare, u dëbuan rreth 1 milion shqiptarë nga Kosova, u kryen rreth 400 masakra dhe u vranë rreth 1 300 fëmijë drejtpërdrejt të

orkestruar, të dirigjuar, të urdhëruar nga shteti i Serbisë. Presidenti Thaçi ka falënderuar të gjithë përfaqësuesit ndërkombëtarë që për herë të parë morën pjesë në një akademi të organizuar për masakrën e Reçakut. "Një falënderim përlulës shkon për ambasadorin Walker, që asnjëherë nuk na la vetëm edhe kur zyrtarët ndërkombëtarë nuk na vizitonin kurrë", ka thënë Thaçi.

Kreu i shtetit ka thënë se qytetarët e Kosovës, familjet e dëshmorëve kanë qenë, janë dhe vazhdojnë të mbesin të dëshpëruara dhe natyrisht të revoltuara. "Dua ta them shumë hapur se kjo heshtje ndërkombëtare dhe pothuajse në një formë a formën tjetër kjo amnisti ndërkombëtare e gjenocidit të Serbisë të kryer në Kosovë i inkurajoi dhe i trimëroi autoritetet shtetërore të Serbisë që të pretendojnë, ta mohojnë edhe krimin, masakrën në Reçak", ka thënë ai.

Thaçi ka thënë është koha që të gjithë pa hezitim ta themi të vërtetën dhe natyrisht që kryerësit që janë bartës edhe të institucioneve në Serbi të gjenocidit, të spastrimit etnik dhe masakrave të tjera në Kosovë, të dhunimeve, të dalin para drejtësisë ndërkombëtare. Homazhe të mërkurën në Reçak ka bërë edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, i cili ka thënë se Reçaku është një ngjarje e cila e ka ngritur botën demokratike në këmbë, për t'i dalë në krah popullit të Kosovës. Ai ka thënë se pas masakrës së Reçakut më askush nuk kishte

Presidenti Meta: Masakra e Reçakut, sakrificë që solli lirinë

Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka bërë homazhe në Kompleksin Memorial në Reçak. Ai ka thënë se masakra e Reçakut e kishite vënë në lëvizje diplomacinë ndërkombëtare për ta ndalë gjenocidin serb në Kosovë. "Kjo masakër dhe sakrificë e pashembullt e Reçakut vuri në lëvizje diplomacinë ndërkombëtare për ta ndalë gjenocidin në Kosovë dhe përmes ndërhyrjes së NATO-s. Kjo masakër dhe të tjerat në kuadër të një plani për spastrim etnik, me të gjitha zhvillimet dhe pasojat e saj, në fund tregoi që liria dhe dinjiteti njerëzor gjithmonë triumfojnë ndaj dhunës dhe barbarizmit. Ishte kjo sakrificë që solli lirinë", ka thënë Meta.

dysim se cili ishte populli çlirimtar dhe liridashës, e cili është shteti gjenocidal në Kosovë. Konjufca shtoi se nuk do të ndalen së kërkuari që kriminelët të dalin para drejtësisë.

Me rastin e 21-vjetorit të masakrës së Reçakut homazhe kanë bërë edhe lideri i LV-së, Albin Kurti, nënkryetarja e LDK-së, Vjosa Osmani, lideri i PDK-së, Kadri Veseli, një delegacion i AAK-së dhe lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj.

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

REÇAK, 15 JANAR - Më 15 janar të vitit 1999, në orët e hershme të mëngjesit, në fshatin Reçak u dëgjuan të shtënat e para nga armët e zjarrit. Të frikësuar, banorët u grumbulluan nëpër shtëpi dhe bodrume në përpjekje për ta shpëtuar vetveten dhe familjarët e tyre. Forcat policore dhe ushtarake serbe u futën në fshat, ku pas disa orësh të zhvillimit të operacionit, vranë 45 civilë shqiptarë. Liderët e shtetit të Kosovës dhe ata partiakë të mërkurën kanë bërë homazhe me rastin e 21-vjetorit të masakrës së Reçakut. Po ashtu, është mbajtur edhe një akademi përkujtimore për martirët e masakrës së Reçakut. Presidenti Thaçi në fjalën e tij në akademinë përkujtimore ka theksuar se viti 1998 për Kosovën ishte një vit i mbushur me tmerre nga dhuna shtetërore e Serbisë, ku masakrat vazhdonin në Prekaz, Likoshan, Abri dhe anekënd Kosovës. "Ishin vrarë mbi 2 000

civilë shqiptarë dhe mijëra të tjerë të plagosur. Rreth 350 mijë civilë vazhdonin të mbeteshin në male për shkak të shtëpive të rënuara nga ushtria dhe policia serbe dhe për shkak të dëbimit të dhunshëm. Kjo dhunë bëhej në sy të botës", ka thënë Thaçi. Kreu i shtetit ka thënë se institucionet ndërkombëtare ishin kufizuar vetëm në disa rezoluta të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, nëpërmjet të cilave i kërkohej Serbisë së Sllobodan Milosheviqit që ta ndalte dhunën dhe ta shmangte rrezikun e një krize humanitare në Kosovë. Sipas tij, 21 vjet më parë, në këtë fshat të vogël të Kosovës, por shumë krenar, ndodhi një krim i madh shtetëror, nga më të shëmtuarit pas Srebrenicës, nga shteti i Serbisë. "U ekzekutuan mbi 40 civilë shqiptarë, duke filluar nga moshja 13-vjeçare e deri në moshën 82-vjeçare. Ky veprim gjenocidal shkaktoi një revoltë të paparë në planin gjithëkombëtar, por edhe në rrafshin ndërkombëtar", ka shtuar ai.

Walkerit: Reçaku përfaqëson atë se çfarë ndodhi në të gjithë Kosovën

Ish-shefi i misionit të OSBE-së në Kosovë dhe njeriu që doli publikisht para 21 vjetësh duke dhënë alarmin për krimet serbe në Kosovë, Willaim Walker, bëri homazhe të mërkurën në Kompleksin Përkujtimor në Reçak. Walkeri ka thënë se është i kënaqur që njerëzit vijnë dhe nderojnë të rënët e Reçakut pasi, sipas tij, kjo simbolizon gjithë atë çfarë ka ndodhur në Kosovë gjatë luftës së fundit. Ai shtuar se populli i Kosovës duhet të kujtojë çdo masakër tjetër që ka ndodhur njëjtë sikurse këtë të Reçakut. "Jam shumë i kënaqur se çdo vit më shumë njerëz nga Kosova vijnë të shohin se çfarë Reçaku është, atë që përfaqëson. Unë nuk jam i lumtur, por i kënaqur që i kushtohet më shumë vëmendje asaj se çfarë ka ndodhur këtu sepse përfaqëson atë se çfarë ka



ndodhur në të gjithë Kosovën. Jam i familjarizuar me masakrën e Reçakut, por kishite dhjetëra e qindra masakra të tjera dhe shpresoj që populli i Kosovës t'i kujtojë ato masakra ashtu siç e kujtojnë masakrën e Reçakut, ajo se çfarë ndodhi këtu dhe ajo se çfarë ndodhi me

krimet e tjera të luftës nëpër Kosovë", ka thënë ai. Walker tha se është i lumtur sa herë vjen në Reçak për shkak të dashurisë dhe respektit që merr nga banorët. Megjithatë, ai theksoi se gjithnjë i kujtohet ajo ditë e para 21 vjetësh dhe për tmerin që kishte parë.



Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) i përgjigjet me kundërofertë Lëvizjes Vetëvendosje (LV)

LDK-ja refuzon ofertën e LV-së,



Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka refuzuar ofertën për bashkëqeverisje të Lëvizjes Vetëvendosje për shtim të numrit të ministrive në 14 sosh. Kjo parti të mërkurën i ka nisur një propozim të ri LV-së që ishte diskutuar më 8 janar në mes të krerëve të dy partive. Përmes këtij propozimi LDK-ja kërkon që ta ketë postin e kryeparlamentarit deri në zgjedhjen e presidentit, i cili do të jetë kandidat i propozuar nga LDK-ja, ndërsa ndarja e 12 ministrive të jetë ashtu siç janë pajtuar në fillim, 5 me 5. Komitetet pakicë do t'i kenë vetëm dy ministri

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 15 JANAR - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) edhe në mënyrë të shkruar i ka kërkuar Lëvizjes Vetëvendosjes (LV) pozitën e kryeparlamentarit nëse dëshiron të ketë marrëveshje për bashkëqeverisje. Derisa ka refuzuar ofertën e fundit të Albin Kurtit për shtim të ministrave në 14 sosh, LDK-ja dëshiron që ta ketë kryetarin e

Kuvendit derisa të bëhet zgjedhja e presidentit, e më pas ajo pozitë do t'i rikthehet sërish LV-së. "LDK-ja do ta ketë kryetarin e Kuvendit deri në zgjedhjen e presidentit, pastaj kryetari i Kuvendit do t'i kalojë LV-së. Kjo nënkupton se në vitin e parë të bashkëqeverisjes secili partner mban një pozitë të lartë shtetërore (LV-ja e ka kryeministrin, LDK-ja kryetarin e Kuvendit). Ndërkaq, në tri vitet e tjera LV-ja mban dy pozita të

larta shtetërore (kryeministrin dhe kryetarin e Kuvendit), kurse LDK-ja një pozitë (presidentin, por që shërben si faktor unifikues sipas Kushtetutës)", është thënë në ofertën e LDK-së.

Pika e dytë e ofertës së LDK-së parasheh që të mos ndodhë rritja e numrit të ministrive. "Numri i ministrive mbetet 12 dhe struktura e tyre mbetet siç është dakorduar më herët, me këto përjashtime: a) Ministria e

Kulturës, Rinisë dhe Sportit i bashkohet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; b) Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ndahet nga Ministria e Punëve të Brendshme, ku është integruar sipas marrëveshjes së arritur në takimet e mëparshme, dhe mbetet për komunitetet joshumicë krahas Ministrisë për Komunitete dhe Kthim", është thënë në ofertën e LDK-së, duke shtuar se partnerët e koalicionit në përputhje me dispozitat kushtetuese për presidentin e vendit do ta përkrahin kandidatin e propozuar nga LDK-ja. Deri në zgjedhjen e presidentit LV-ja do t'i ketë: kryeministrin, nënkryetarin e parë të Kuvendit, zëvendëskryeministrin e dytë dhe pesë ministri, ndërkaq LDK-ja do t'i ketë: kryetarin e Kuvendit, nënkryetarin e parë të Kuvendit, zëvendëskryeministrin e dytë dhe pesë ministri. Kurse pas as zgjedhjes së presidentit,

të propozuar nga LDK-ja, LV-ja do t'i ketë: kryeministrin, kryetarin e Kuvendit, nënkryetarin e parë të Kuvendit, zëvendëskryeministrin e dytë dhe 5 ministri, ndërkaq LDK-ja do t'i ketë: presidentin si kandidat të saj të propozuar (por që si president vepron si faktor unifikues sipas Kushtetutës), si dhe nënkryetarin e dytë të Kuvendit, zëvendëskryeministrin e parë dhe 5 ministri.

Pasi ka bërë publike kundërofertën, lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka dalë në një konferencë për medie, ku ka thënë se tani presin se si do të veprojë partia e Albin Kurtit. "Ajo është ofertë që ne e kemi trajtuar gjatë bisedave tona. Ne kemi kërkuar që LV-ja pas datës 26 ta sqarojë pozicionin e saj lidhur me partneritetin e mëtutjeshëm dhe si e sheh vendin e LDK-së në këtë partneritet. Së pari të sqaroj se ne nuk duam të bëjmë asnjë marrëveshje për bashkëqeverisje

kërkon kryeparlamentarin

tillë, nuk e shqyrtojmë një pozicionim të tillë, por i trajtojmë qëndrimet tona. Qëndrimi i Këshillit ka qenë ky që ne të kemi këto pozita dhe çdo ndryshim nuk mund të bëhet pa marrje të verifikimit në organet tona", ka thënë Mustafa.

Në ofertën e së hënës që LV-ja i kishte dërguar LDK-së kishte propozuar që kësaj partie t'i jepet vetëm një ministri më tepër. "E shtojmë numrin e ministrive në qeveri, nga 12 në 14 sosh, me ç'rast Lëvizja Vetëvendosje i ka 5 ministri, kurse Lidhja Demokratike e Kosovës i ka 6 ministri. Ministria shtesë për LDK-në vjen si pjesë e njëres prej ministrive më të mëdha që ka LV-ja. 3 ministri i kanë pakicat, siç edhe parashihet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Vlen dakordimi i mëhershëm që zëvendëskryeministri i parë i takon LDK-së, ndërkaq zëvendëskryeministri i dytë LV-së", ishte thënë në ofertën e LV-së.

Në pikën e dytë të propozimit të LV-së Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ndahet, ashtu që Kultura dhe Rinia i bashkëngjiten Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe

Përplasen nënkryetarët e LDK-së

Zyrtari i parë i LDK-së që e ka refuzuar ofertën e LV-së ka qenë nënkryetari Agim Veliu, duke thënë se përpjekja e LV-së për marrëveshje nuk është serioze. "Angazhimi dhe veprimet e ditëve të fundit të LV-së nuk janë përpjekje serioze për ndërtimin e institucioneve dhe arritjen e marrëveshjes me LDK-në për të bashkëqeverisje mbi bazën e fuqisë së votës. E tërë kjo është një përpjekje e LV-së për pushtet absolut dhe për ta nënshtruar e nënçmuar LDK-në, duke provuar t'ia nëpërkëmbin dinjitetin. Madje kërkesat e sotme të LV-së shko-

jnë edhe më larg, në synimin e tyre që LDK-ja të shkëputet nga e kaluara e saj evropiane dhe euroatlantike", ka shkruar Veliu në profilin e vet në "Facebook".

I menjëhershëm ka qenë reagimi i nënkryetares tjetër të LDK-së, Vjosa Osmani, duke e kundërshtuar qëndrimin e Velikut.

Ish-kandidatja e LDK-së për kryeministre në profilin e vet në "Facebook" ka shkruar se para një viti kur LDK-ja kundërshtoi shfuqizimin e Gjykatës Speciale, vetëm LV-ja i kishte dalë në përkrahje. "Atë ditë është rikonfirmuar orientimi

properëndimor dhe euroatlantik. Atë nuk e bëri LDK-ja vetë, e as LV-ja vetë, por e bëri LDK-ja dhe LV-ja bashkë, me bekimin e miqve tanë ndërkom-bëtarë. Pyetja që shtrohet sot për kundërshtuesit, penguesit e bllokuesit e ndryshimit, në një kohë kur Kosova rrezikon të zbrazet e të shndërrohet në shtet të dështuar, është pikërisht e njëjtë me atë që ambasadori i atëhershëm amerikan e bëri në zyrat tona në orët e vona të mbrëmjes në 2017-n ku ishin bashkuar zyrtarë nga LDK-ja e LV-ja: Çfarë do t'ju duhet partia kur nuk do të ketë më Kosovë?", ka shkruar Osmani.

Teknologjisë, ndërsa Sporti i bashkëngjitet Ministrisë së Shëndetësisë. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal janë dy nga tri ministrinë që u jepen paki-

cave. Ministria e tretë është ajo për Komunitete.

Sa i përket pikës për presidentin, LV-ja kishte paraparë të bëhet një formulim i përbashkët për çështjen e presidentit të Republikës së

Kosovës bazuar në draftin fillestar nga LDK-ja që përfshin qëndrimin karshi presidentit aktual, përpjekjen për konsensus dhe kufizimin karshi ujdive eventuale me ish-PAN-in.

Thaçi flet me Borrellin: Kosova ka përmbushur kushtet për vizat

PRISHTINË, 15 JANAR (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka zhvilluar të mërkurën një bisedë telefonike me përfaqësuesin e lartë për politikë të jashtme dhe siguri të BE-së, Josep Borrell, me të cilin ka diskutuar për perspektivën evropiane dhe zhvillimet në Kosovë dhe rajon. Presidenti Thaçi dhe përfaqësuesi i lartë i BE-së u pajtuan për nevojën e themelimit sa më shpejt të institucioneve të reja qeverisëse në Kosovë. "Jemi të vetëdijshëm që na presin detyra të mëdha dhe se është e nevojshme që sa më parë të kemi qeveri të re, që do të përballet me sfidat dhe do t'i realizojë obligimet ndërkombëtare që ka Kosova", u shpreh presidenti Thaçi.

Presidenti Thaçi ka theksuar se Kosova është e përkushtuar t'i përfundojë reformat që ka nisur dhe të cilat janë përcaktuese për anëtarësimin e Kosovës në BE. Presidenti Thaçi kërkoi që BE-ja ta përmbushë obligimin për heqjen e vizave për qytetarët e Kosovës, sepse Kosova ka përmbushur të gjitha kriteret e nevo-



jshme. "Kosova ka përmbushur të gjitha kushtet. Parlamenti dhe Komisioni Evropian kanë rekomanduar heqjen e vizave për Kosovën. Qytetarët e Kosovës me të drejtë presin vendim meritore në këtë pikë", ka thënë presidenti Thaçi në bisedën telefonike me përfaqësuesin e lartë Borrell.

Presidenti Thaçi dhe përfaqësuesi i lartë i BE-së u pajtuan rreth nevojës që të vazhdojë dialogu i pakushtëzuar në mes të Kosovës dhe Serbisë si dhe për domosdoshmërinë e arritjes së marrëveshjes përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë e cila nënkupton njohjen reciproke ndërmjet dy shteteve.

Në fund të bisedës, presidenti Thaçi ka thënë se e mirëpret vizitën e përfaqësuesit të lartë të BE-së, Josep Borrell, në Republikën e Kosovës. Përfaqësuesi i lartë për politikë të jashtme dhe siguri të BE-së, Josep Borrell, ka zhvilluar një bisedë telefonike edhe me presidentin e Serbisë.

nëse nuk është marrëveshje partneriteti, në të cilën të dyja palët do të ndiheshin të fuqishme për aq sa kanë marrë besimin e qytetarëve të Kosovës. Në këto biseda ne e kemi dhënë pozicionin për mënyrën se si të përafrohemi dhe gjejmë zgjidhje, pa marrë parasysh si e cilësojmë ne si zgjidhje politike, si ofertë ose si bazë për arritje të marrëveshjes", ka thënë Mustafa.

Më tutje, Mustafa ka thënë se nuk e kanë vlerësuar atë që ka propozuar LV-ja, e që e njëjta, sipas tij, do të vlerësohet në organet e partisë. "Ne nuk e vlerësojmë atë që na ka shkruar Vetëvendosje sepse në qoftë se e trajtojmë në organet tona, trajtohen vetëm parimet mbi të cilat ne vazhdojmë të bëjmë biseda. Në asnjë rast nuk kemi kërkuar shtim të ministrive, ndryshim, këmbim të ministrive, por kemi kërkuar marrëveshje të partneritetit. Prandaj, si të

Quni e Haskuka biseduan për qeverisjen lokale në Prizren

PRIZREN, 15 JANAR (ER) - Kryetari i Degës së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) në Prizren dhe deputeti i Kuvendit të Kosovës, Anton Quni, është takuar të mërkurën me kryetarin e kësaj komune, Mytahir Haskuka, me të cilin ka biseduar për qeverisjen lokale.

Quni në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se si partner të qeverisjes në Prizren do të bëjnë gjithçka në të mirë të qytetarëve të këtij qyteti. "Në vazhden e përpjekjeve për ta bërë sa më të mirë dhe më të besueshme qeverisjen lokale në Prizren sot kam takuar

kryetarin e komunës, Mytahir Haskuka. Si dy partnerë në qeverisje jemi zotuar që të bëjmë gjithçka që është e mundur që qytetarëve të Prizrenit t'u ofrohen shërbime më të mira e më cilësore përgjatë vitit në të cilin sapo kemi hyrë", ka shkruar Quni.



Mbahet ligjëratë për mbrojtjen e fëmijëve

MITROVICË, 15 JANAR (ER) - Mbështetur në planin e punës së Qendrës për Punë Sociale (QPS) në Mitrovicë për vitin 2020, drejtori i kësaj qendre, Gani Mustafa, së bashku me përfaqësuesin e OJQ "Handikos", Edin Lahi, dhe në prani të drejtorit të shkollës "Musa Hoti", Skender Avdiu, kanë mbajtur ligjëratë lidhur me rolin e QPS-së për mbrojtje të fëmijëve e nxënësve të kësaj shkolle.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte sensibilizimi i nxënësve lidhur me rolin e QPS-së për ofrimin e shërbimeve sociale të familjeve apo personave me nevojë sociale si dhe bashkëpunimi ndërinstitucional me qëllim parandalimin e dukurive negative nëpër shkolla. Me këtë rast, janë përgatitur disa broshura të cilat iu kanë shpërndarë të gjithë nxënësve, ku të njëjtat pritet t'u shpërndahen edhe institucioneve arsimore dhe atyre



shëndetësore, pasi shpesh ofruesisht e shërbimeve nga këto institucione mund t'i identifikojnë rastet të cilat nuk mund të vërehen nga aktorët e tjerë.

Në fjalën e tij drejtori i QPS-së, Gani Mustafa, ka shpjeguar për nxënësit rolin e kësaj qendre për mbrojtjen e fëmijëve, duke i njohur ata me mënyrën e raportimit për secilin dyshim në keqtrajtim të fëmijëve, për ta ndihmuar kështu QPS-në për realizimin e detyrës së saj, si dhe për rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve në mjedise të sigurta.

Ndërsa përfaqësuesi nga "Handikos", Edin Lahi, ka përmendur disa prej grupeve të fëmijëve në nevojë të cilët më së shumti marrin shërbim nga QPS-ja. Në anën tjetër, drejtori i shkollës "Musa Hoti", Skender Avdiu, ka falënderuar drejtorin Mustafa dhe përfaqësuesin e "Handikos"-it për iniciativën e ndërmarrë.

Vitin e kaluar Komuna e Gjilanit ka mbështetur 2 339 fermerë

GJILAN, 15 JANAR (ER) - Në Komunën e Gjilanit gjatë vitit 2019 janë mbështetur me subvencione 2 339 fermerë ose 83 për qind nga të gjitha kërkesat e tyre. "Gjatë 2019-s kemi pranuar 2 805 kërkesa për mbështetje dhe aplikacione për subvencione, prej të cilave pozitivisht iu kemi përgjigjur 2 339 prej tyre ose 83 për qind, ndërsa janë refuzuar 466 kërkesa. Jemi të lumtur kur të arrijmë që të gjitha kërkesave t'i u përgjigjemi pozitivisht", ka deklaruar drejtori i Bujqësisë në Gjilan, Ramiz Ramadani, në konferencën për medie. Sipas tij, mbështetja ka shkruar në subvencionimin e mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore si masë e përhershme, në

mekanizim bujqësor, serra për perimtarët, shtëpiza për bletarët, makina mjelëse për blegtorët, sikurse edhe ngritja e 15 hektarëve me kulturë të arrës. Ai ka thënë se 2019-shi ka qenë i bereqetshëm edhe sa i përket mbështetjes së donatorëve, kryesisht të huaj. "Faleminderit shumë Komisionit Evropian, IADK, shkollës së mesme të agro-biznesit 'Arbëria', OZHR 'Mëshqerra' etj., për mbështetjen e jashtëzakonshme për realizimin e projekteve tona. Me këtë mbështetje u është lehtësuar jashtëzakonisht shumë puna fermerëve të Gjilanit. Po ashtu, faleminderit kryetarit Haziri për mbështetjen e madhe, duke e ruajtur



bujqësinë si prioritetin e parë të qeverisjes", ka deklaruar

Ramadani, duke shtuar se mbështetja për fermerët gj-

lanas do të vazhdojë edhe në vitin 2020.

Komuna e Vushtrrisë vazhdon t'i mbulojë shpenzimet e varrimit për vushtrriasit

Vushtrri, 15 janar (ER) - Komuna e Vushtrrisë dhe Këshilli i Bashkësisë Islame në Vushtrri e kanë vazhduar memorandumimin përmes të cilit kjo komunë do të vazhdo-

jë për të tretin vit me radhë t'i mbulojë shpenzimet për ritet fetare të varrimit. Në bazë të memorandumit Komuna e Vushtrrisë do t'i mbulojë shpenzimet për këto rite: kry-

erjen e ritualeve të varrimit sipas traditave fetare islame, pastrimin e kufomës, qefinin, dërrasat, piramidat me mbishkrim dhe transportin e kufomës. Për shkak të

mungesës së fuqisë punëtore, me kërkesë të Këshillit të Bashkësisë Islame në Vushtrri shpenzimet e hapjes së varrit nuk janë përfshirë në këtë memorandum.



PDK-ja emëron zëdhënësin dhe drejtorin për komunikim në parti

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 15 JANAR - Partia Demokratike e Kosovës (PDK), pas zgjedhjes së kryesisë së re, me propozim të kryetarit të partisë, Kadri Veseli, ka emëruar dy zyrtarë përgjegjës për komunikim dhe marrëdhënie me publikun.

Shefi i kabinetit të kryetarit Veseli, Avni Bytyçi, është emëruar në pozitën e zëdhënësit të partisë, ndërsa Bashmir Xhemaj është emëruar drejtor i Zyrës së Komunikimit në PDK. Para se të shërbente në pozitën e zëdhënësit të PDK-së, Avni Bytyçi ishte për dy mandate zëvendësues i stafit të kryeparlamentarit Kadri Veseli. Më parë, Avni Bytyçi ishte angazhuar në sektorin e shoqërisë civile, duke mbajtur pozita të ndryshme menaxheriale dhe udhëheqëse, duke

avokuar për demokraci dhe institucione transparente dhe llogaridhënëse.

Në vitin 2013 ai ka pranuar bursën Fulbright nga Departamenti i Shtetit Amerikan për t'i vazhduar studimet. Pas përfundimit të studimeve themelore, drejtimin e Shkencave Politike në Universitetin e Prishtinës, ka ndjekur studimet e nivelit Master në "Maxwell School of Citizenship and Public Affairs" në Universitetin Syracuse në Nju Jork të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Ndërsa drejtori i Zyrës së Komunikimit, Bashmir Xhemaj, ka diplomuar në shkencë politike dhe magjistruar për komunikim në Universitetin e Sheffildit, Fakulteti Ndërkombëtar në Selanik. Ka përvijë të gjatë në gazetari dhe shoqëri civile. Nga viti 2014 ka punuar si këshilltar në



Ministrinë e Jashtme dhe më vonë këshilltar i lartë i zëvendëskryeministrit të Kosovës, Enver Hoxhaj. Partia Demokratike e Kosovës



që nga themelimi i saj dhe me përvijë gati dy dekada si parti politike, ka kultivuar çdoherë një raport të veçantë dhe të afërt me mediat dhe publikun.

Emërimet e reja do ta forcojnë edhe më shumë këtë lidhje dhe rritin bashkëpunimin e përditshëm me të gjitha palët e interesit.

Një person vdes si pasojë e gripit

PRISHTINË, 15 JANAR - Më shumë se 16 000 është numri i raportuar i personave të prekur nga gripit muajt e fundit në Kosovë, prej të cilëve një rast ka përfunduar me vdekje. Këto të dhëna janë konfirmuar nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës. Nga numri i të prekurve, sipas këtij Instituti, rreth 3 000 janë cilësuar si infeksione respiratore akute, kurse 13 raste me infeksion të rëndë respirator akut.

Sali Ahmeti, infektolog, duke



folur për "Radion Evropa e Lirë", ka pohuar se gjatë muajit janar dhe më tej pritet fluks edhe më i madh i të prekurve me gripin sezonal, i cili, sipas tij, deri më

tani ka qenë grip me influencë "A". "Në Klinikën Infektive aktualisht kemi të shtrirë katër persona të konfirmuar me grip, derisa tashmë një person ka humbur jetën si pasojë e gripit. Ndërkaq, gjithsej janë 11 raste të konfirmuara me grip në Kosovë. Ndonëse deri tani ka pasur fluks, fluksi edhe më i madh pritet tash e tutje, pasi jemi në sezonin që presim të kemi numër më të madh me influencë me gripin 'A'. Ky grip ndonjëherë është kër-

cënues, sidomos te personat me sëmundje kronike", ka thënë Ahmeti.

Pavarësisht numrit në rritje të pacientëve me grip, në Klinikë Infektive, thekson Ahmeti, mungon ilaçi i quajtur 'Tamiflu', i cili shërben për trajtimin e personave të prekur me virus sezonal. "Sa iu përket barnave jemi të furnizuar, ndonëse nuk kemi 'Tamiflu', ilaç për virusin, por kemi zëvendësime të tjera të barnave antivirale. Përndryshe, në

Klinikën Infektive mund të them se kemi kapacitete si me burime humane, po ashtu edhe me hapësirë edhe në ndonjë rast të shpërthimit epidemik të gripit", ka thënë Ahmeti.

Ndërkaq Era Pireva, zëdhënëse në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik, ka bërë me dije se numri më i madh i rasteve me grip është raportuar nga Komuna e Prishtinës dhe Prizrenit. Megjithatë, ajo shton se gripin nuk ka kaluar prapagun epidemik.

Përurohët salla e tretë operative në Kirurgjinë Vaskulare

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 JANAR - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka marrë pjesë të mërkurën në përvijë të sallës së tretë operative në Kirurgjinë Vaskulare. Gjatë përvijës të kësaj sale ministri Ismaili ka thënë se është shumë i lumtur me investimet që janë bërë në këtë klinikë.

Ministri Ismaili ka theksuar se hapja e kësaj sale do të ndihmojë që të hiqet lista e pritjes për qytetarët. "Jam jashtëzakonisht i lumtur me investimet që po shoh se janë realizuar këtu. Kjo ka qenë një kërkesë e kamotshme e Kirurgjisë Vaskulare, që të ketë edhe një sallë tjetër. Një sallë që është moderne, që i plotëson kushtet t'u shërbejë pacientëve me

kualitet sa më të lartë. Duke krijuar hapësira moderne si kjo do të jemi në gjendje t'i shtojmë shërbimet dhe ta heqim listën e pritjes. Në këtë mënyrë do ta ruajmë shëndetin dhe xhepin e qytetarëve", ka shtuar ministri Ismaili.

Drejtori i ShSKUK-së, Basri Sejdiu, ka thënë se qëllimi i këtyre investimeve është që pacientëve t'u bëhet më i lehtë mjekimi dhe shërimi. "Gradualisht po ngrehim shërbimet profesionale në QKUK që qytetarëve tanë t'u ofrojmë më shumë mundësi për t'i trajtuar problemet e tyre shëndetësore", ka thënë drejtori Basri Sejdiu.

Drejtori i Klinikës së Kirurgjisë Vaskulare, Hajriz Rudari, ka thënë se me sallën e tretë operative pacientët do të kenë kushte më të mira dhe mundësi më të mëdha trajtimi. Për sallën e re



operative në Kirurgjinë Vaskulare janë shpenzuar mbi

100 mijë euro, ndërsa 100 mijë euro të tjera janë shpenzuar për

modernizmin me pajisje të sallave ekzistuese.

Vlera e mallrave të liruara për prodhues në import për vitin 2019 është 370 milionë euro

PRISHTINE, 15 JANAR (ER) - Bazuar në politikat fiskale në vitin 2019 vlera e mallrave që janë importuar me zero taksa në import për prodhuesit e Kosovës në vitin 2019 ka qenë 370 milionë euro apo 10.5 për qind e totalit të vlerës së importit në 2019-n. Kështu është bërë me dije në një njoftim të Doganës së Kosovës. "Ndikimi në taksat në import që iu referohen mallrave të liruara për prodhueset përgjatë vitit 2019 është rreth 81.5 milionë euro, që paraqet një rritje prej 9.7 përqindësh krahasuar me vitin paraprak 2018. Nga kjo shumë prej 81.5 milionë eurosh, ndikimi në taksën doganore ka qenë 9 milionë euro, 11.5 milionë euro në taksën e akcizës dhe 61 milionë euro në TVSh", është thënë në njoftimin e Doganës.

Sa i përket MSA-së, Dogana ka bërë me dije se ndikimi në të hyra nga MSA-ja përgjatë kësaj periudhe është rreth 64 milionë

euro apo rreth 47 për qind më shumë sesa periudha e njëjtë e vitit paraprak 2018. "Gjithashtu, ndikim në të hyra ka pasur edhe marrëveshja e tregtisë së lirë me Turqinë që ka hyrë në fuqi më 1 shtator 2019, ku efekti në të hyra në import nga kjo marrëveshje për katër muaj ishte në vlerë 2.5 milionë euro. Totali i lirimeve për prodhues, ndikimi i MSA-së dhe MTL me Turqinë për vitin 2019 kanë pasur efekt 148 milionë euro në taksat importuese. Shpresojmë se ndikimi i këtyre politikave fiskale, MSA-së, Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë, ka pasur efektin e vet pozitiv në ekonominë e Kosovës, për prodhuesit kosovarë në ngritjen e kapaciteteve të tyre prodhuese, në zëvendësimin e produkteve në import dhe rritjen e eksporteve të produkteve kosovare drejt vendeve të tjera", është theksuar në njoftimin e Doganës.



ATK-ja inkason 33.4 milionë euro borxhe më shumë



EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 15 JANAR - Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Ilir Murtezaj, ka shpallur të mërkurën rezultatet e punës për vitin 2019. Para mediave u prezantuan statistika të shumta të aktiviteteve të zhvilluara në vitin 2019, të cilat kanë dhënë rezultate pozitive për realizimin e objektivave të parapara. Gjatë kësaj konference Murtezaj ka thënë se viti 2019 do të mbahet

mend për realizimin e mbi gjysmë miliardi euro (504,503,833) të hyra si dhe për zvogëlimin e stokut të borxheve për 21.8 milionë euro, ku njëkohësisht është arritur të inkasohen 33.4 milionë euro borxhe më shumë apo shprehur në përqindje 44.7 për qind më shumë se viti 2018. "Realizimi i të hyrave dhe zvogëlimi i borxheve tatimore nuk kanë qenë synime të vetme të administratës tatimore, sepse në vitin 2019 fokus të veçantë ka pasur edhe luftimi dhe parandalimi i ekonomisë joformale ku,

përveç shumë aktiviteteve që janë zhvilluar për këtë fushë, vitin që shkoi ATK-ja ka hartuar Planin për Përmirësimin e Përbushjes në Sektorin e Ndërtimtarisë 2019-2021, ku përmes këtij plani ATK-ja do të kryejë aktivitete intensive me qëllim të identifikimit të personave të cilët nuk përbushin detyrimet e tyre sipas legjislacionit tatimor. Ky plan është pjesë e planit afatmesëm të reformës 2019-2021, në të cilin hynë edhe reforma të tjera, si ajo e konsolidimit të mbledhjes së detyrueshme,

automatizimit të proceseve të punës, rimbursimit të TVSh-së, kontrollit tatimor, si dhe modernizimit të teknologjisë informative", ka thënë ai.

Në këtë konferencë ishte i pranishëm zëvendësministri i Financave, Fatmir Gashi, i cila ka thënë se "Administrata Tatimore e Kosovës me punën dhe angazhimin e treguar na bënë të ndihemi krenarë secilin prej nesh, duke pasur parasysh se janë tejkaluar parashikimet e parapara për vitin 2019". Ai ka shtuar se ulja e nivelit të borxheve në këtë masë

kaq të madhe ul edhe ekonominë joformale në vend. Po ashtu, Gashi ka potencuar se Ministria e Financave do të jetë mbështetësja më e madhe e ATK-së për arritjen e misionit të saj.

Në përmbyllje të kësaj konference, drejtori i ATK-së ka falënderuar mediat për bashkëpunimin e ofruar në vazhdimësi, për promovimin e aktiviteteve të ATK-së, në të njëjtën kohë ka kërkuar nga të gjithë tatimpaguesit që t'i kryejnë me kohë obligimet tatimore të përcaktuara me ligj.

Investime selektive të Fondit Pensional në tregun e Kosovës

PRISHTINË, 15 JANAR - Rreth 500 milionë euro nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës vitin e kaluar janë investuar në tregun e Kosovës, thonë zyrtarë të këtij institucioni. Paratë e këtij fondi, sipas udhëheqësve të këtij institucioni, do të investohen në tregun vendor, por prioritet, sipas tyre, mbetet interesi i kontribut-paguesve.

Rreth 2 miliardë euro ka arritur vlera e mjeteve të mbi 660 mijë kontribut-paguesve në Kosovë, që i menaxhon Fondi i Kursimeve Pensionale. Nga kjo vlerë, 75 për qind e mjeteve mbahen në tregjet financiare ndërkombëtare, kurse 25 për qind në Kosovë.

Kryesuesi i Bordit Drejtues të këtij institucioni, Ruzhdi Morina, ka thënë se Bordi mirëpret çdo mundësi për investime në Kosovë. "Derisa në vitin 2018, rreth 20 për qind ose 328 milionë euro ishin të investuara në Kosovë, në vitin 2019 rreth 25 për qind ose rreth 500 milionë euro janë investuar në vend. Bordi mirëpret çdo mundësi për investime në vend, por gjithnjë duke pasur për bazë vetëm interesin e kontribuuesve", ka thënë Morina.

Instrumentet financiare më të leverdishme ku Trusti mund të investojë në Kosovë janë letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës dhe depozitat bankare, thotë drejtori i menaxhmentit të Trustit Pensional të Kosovës, Ardian Zalli. "Në këtë rast këto dy instrumente ofrojnë norma të ulëta të kthimit. Kështu që ne patjetër detyrohemi të investojmë në tregjet ndërkombëtare dhe shpresojmë që në të ardhmen do të ketë mundësi të tjera financiare ku do të gjenerojmë norma më të larta të kthimit të interesit. Për shkak se Trusti është i thirrur të punojë dhe investojë në interes të kontribuuesve dhe duhet shikuar se ku



janë normat më të larta aty duhet të orientohet investimi", është shprehur Zalli.

Për qindja më e madhe e këtyre mjeteve janë të investuara në tregjet e Gjermanisë, Japonisë, Anglisë, Francës dhe në tregjet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Riadhësimi i mjeteve të Trustit që mbahen në tregjet financiare ndërkombëtare në tregun e Kosovës vazhdimisht ka qenë kërkesë dhe temë debati nga njohës të çështjeve ekonomike. Ata disa herë kanë deklaruar se është paradoks fakti që Kosova vazhdimisht kërkon donacione, investime të huaja dhe merr kredi ndërkombëtare, kurse

paratë, siç është rasti me Fondin Pensional, mbahen në tregjet e huaja.

Naim Gashi, ekspert për çështje ekonomike, thotë se nevojitet të ndryshohet ligji aktual dhe njëherësh të krijohet një siguri për këto mjete. "Marrë parasysh kredibilitetin që institucionet e Kosovës e kanë aktualisht, mendoj se nuk ka një frymë dhe klimë që këto mjete mund të investohen në Kosovë për arsye se me një shkallë kaq të lartë të rrezikut ekziston mundësia që këto mjete të humbin dhe do të humbin kursimet e pensionistëve kosovarë të cilët kanë kursyer gjatë punës së tyre", ka thënë Gashi për "Radion Evropa

e Lirë".

Sipas Ligjit për fondet pensionale të Kosovës, mjetet pensionale mund të investohen në llogaritë bankare dhe depozitat e bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës, letra me vlerë të ndërmarrjeve, duke përfshirë veçmas stoqet dhe obligacionet dhe fondet e përbashkëta dhe të investimeve varësisht nga miratimi i rregullatorit në Kosovë.

Në konferencën vjetore për media që Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës ka mbajtur të martën është thënë se gjatë vitit 2019 mjetet nën menaxhim

të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës arritën rritjen më të lartë, me fond total rreth 2 miliardë euro, që është një rritje vjetore prej 300 milionë eurosh. Gjatë vitit të kaluar, sipas anëtarëve të Bordit, ky Fond ka arritur performancë pozitive nga investimet prej 8.9 përqindësh. Rreth 161 milionë euro është vlera e kthimit nga investimet.

Në vitin 2018 Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës ka shënuar rënie të performancës prej 5.2 përqindësh, çka ka ndikuar që humbjet të shkojnë deri në 84.7 milionë euro. Bilanci negativ gjatë vitit 2018 ka prekur të gjitha llogaritë e kontribut-paguesve.

OEK-u bën thirrje për zbatim të ligjit, mbrojtje të ambientit dhe mosdëmtrim të imazhit të kompanive



PRISHTINË, 15 JANAR (ER) - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) ka bërë me dije se me vëmendje ka përcjellë zhvillimet dhe debatin publik rreth projektit për ndërtim të hapësirave banuese, në zonën që rrethon liqenin e Badocit. "Duke vlerësuar lart prioritetin e ruajtjes së ambientit, edhe të përkrahjes të investimeve nga kompanitë vendore dhe

ndërkombëtare, ne bëjmë thirrje për të gjitha palët që ta zbatojnë ligjin dhe standardet më të larta ndërkombëtare për ruajtjen e resurseve natyrore, duke respektuar të drejtat e investitorëve jo vetëm në këtë projekt, por edhe në projekte të tjera", është theksuar në komunikatën e OEK-ut. Më tej, thuhet se në rastet kur përgjegjësia institucionale për

zbatim të ligjit është tek institucionet kompetente, duhet të kursehemi nga fushatat kundër kompanive vendore dhe ndërkombëtare të angazhuara për zbatimin e këtij projekti dhe projekteve të tjera, sidomos kur kemi një situatë të paqartë ligjore që nuk është pasojë e veprimeve të kompanive, por është pasojë e (mos)veprimin institucional.

Reçaku i 15 janarit 1999



Muharrem NITAJ

15 janari i vitit 1999 ishte si ky i sotmi, i vranët, me qiellin gri dhe ende pa borë.

Herët në mëngjes e morëm një lajm, se në një fshat të Shtimes, në Reçak, (për të cilin pakkush nga ne kishte dëgjuar) kishte ndodhur një hata, se kishte shumë të vrarë e të sakatosur, dhe që vendi mbahej i rrethuar nga forcat serbe.

U tha se në vendin e ngjarjes do të shkonte edhe ambasadori William Walker, por dy prej nesh, pa prituri njeri, u nisëm turraprap drejt Reçakut.

E gjatë dukej rruga edhe pse kishte 20 e pak kilometra, sepse sikur e ndienim se tmerrri me të cilin do të përballëshim atje ishte korb i zi!

Sapo mbërritëm në udhëkryqin e fshatit, të parët që takuam ishin 10-15 burra e një kallabalëk fëmijë, që po prisnin për të parë se kush do të shkonte nga Prishtina atje, si dhe disa njerëz me tesha të zeza, që sikur mbanin rend e që ishin pjesëtarë të UÇK-së.

Pa një pa dy u mblodhën përreth nesh, secili me rrëfimin e vet, dhe njëri prej burrave, si më i moshuar, na e hoqi udhën për te oborri i shtëpisë së parë në të majtë të rrugës, që ngjitej shpatit mbi Reçak!

Në oborr e para nesh ishte një grumbull me një qilim përmbi dhe burri që e hoqi qilimin dhe që para syve tanë u shfaq një gjysmëtrup i njeriu, veç në shokë

e poshtë, me copa ashti e mishi përreth. Na u tha se i kishin futur bombën në gojë dhe e ajo e kishte copëtuar duke ia marrë gjysmën e trupit!

Kjo ishte pamja e parë në Reçak më 15 janar 1999, e cila do të përsëritej në forma të ndryshme deri në majë të kodrës. Në atë lugun e malit, që i ngjasonte një përroske pa ujë, por me kufoma të renditura njëra pas tjetrës! Dhe maja e malit dhe një gropë e mbetur nga një furrë gëlqereje, e mbushur plot kufoma... edhe ata si të tjerët me poshtë, me kafka të llomitura, me gjymtyrë të thyera, e me trup e shpirt të sakatosur.

Kjo ishte masakra e Reçakut! Pas gjithë këtij tmerrri, që na kishte mpirë e s'po nxirrnim zë, u mblodhëm përreth Ambasadorit William Walker. Ai do të bënte një deklaratë për opinion. Ishte i shkurtër, sa

mbaj mend. Tha se shihej qartë se të vrarët ishin fshatarë të paarmatosur. Dukeshin si bujq e punëtorë! "This is a crime against humanity", tha ambasadori!

Ashtu u pa, ashtu u tha dhe ashtu lajmi mori dhenë! Unë

drejtpërdrejt për BBC-në, me zërin që me dridhej, nga shpati i malit përmbi Reçak, me dhjetëra të masakruar pranë dhe me qindra snajperistë të Millosheviqit përreth që po na vështronin përmes nishanit të pushkës!



Nata e Raçakut, gjenocid ushtarak serb!

Shefqet BYLYKBASHI

Nuk është e lehtë që ta shpalosësh krenarinë dhe dhimbjen e vjetër, për kohën kur, në Kosovë, në role të mëdha ishin Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe diplomacia botërore. Akujt e atij janari të ftohtë lidhen me zjarrin e marsit një vit më herët. Të kër-rusur nga shekujt, me plagë të rënda, një komb i tërë po rilindej nëpër zjarr, gjak, krenari, lot e dhimbje; nëpër dyndje e kthime; nëpër beteja e punë të palodhshme; nëpër humbje e fitore; nëpër dëbime e lindje..., tashmë, duke kaluar nëpër të gjitha këto rrëmujë, kishim krijuar një tru kombëtar, liridashës, çlirimtar; tashmë, në duar të sig-urta i kishim edhe plagët e kombit, edhe ushtarët e plagosur, pavarësisht rrethanave të vështira në atë kohë!

Dhimbja nuk varroset dot. Përtej dhimbjes, është jeta! Për të jetuar pas gjithë këtyre vuajtjeve, duhet krijuar një mbrojtje të qëndrueshme, duhet luftuar! Dhe, njerëzimi, them se vetëm në një rast duhet luftuar: për të mbrojtur lirinë e tij, sa herë që liria e tij rrezikohet!

Njerëzit ngelin të robëruar, gjithnjë, vetëm për shkak se u mungon organizimi dhe kur nuk janë të vetëdijshëm se për tu çliruar nga vargonjtë e robërisë i duhet të luftoj; të luftoj kundër së keqes, për të mirën e tij!

Nata e Raçakut, na bëri që ne, si komb, të nisim dhe të numërojmë zhvendosjet me dhunë nga trojet tona gjithandej Janinës,

Nishit, Manastirit, Gucisë; masakrat, gjenocidet, shfarosjet nëpër shumë e shumë qendra tjera të etnisë sonë dhe t'i thërrasim ndërgjegjes e gjakut tonë atdhetar për një bashkim forcash gjithëkombëtare, për t'i dal në mbrojtje qenies sonë shqiptare. Dhe, nëse ne i numëruam me mendje të kthjelltë të gjitha këto, rezultati doli të jetë pozitiv në të mirë të gjithë kombit tonë!

Njeriu, shpeshherë, në retrospektivë nuk është se numëron një nga një vetëm pushtimet dhe betejat e njëpasnjëshme, si dhe kryengritjet dhe përpjekjet për çlirim, por në hapësirën ndërmjet këtyre ngjarjeve të rënda, ai nuk harron që të vë në spikamë edhe rolin e të gjithë pjesëmarrësve tjerë në ndërmarrjet e mëdha kombëtare, si: popullatës që e kupton mirë rolin e luftëtarëve për liri dhe i mbështetë fort në të gjitha pikëpamjet; diasporës e cila e mbështetë me mjete financiare; lobistëve nëpër kryeqytetet e mëdha botërore dhe qendrat e diplomacisë; si, dhe të mjekëve, të cilët me një hap të ri, bënë që lufta jonë për çlirim të jetë më e përgatitur dhe më e fortë se asnjëherë tjetër në historinë tonë mijëra vjeçare.

Ekzistenca e njeriut nuk është që ai të jetojë gjithnjë duke i përballuar dhimbjet e plagëve me durim të madh, të jashtëzakonshëm, por, që të përgatisë kuadro mjekësore dhe plagëve jo vetëm t'ua lehtësojë dhimbjen, por edhe t'i shërojë! Me këtë përkushtim dhe mision human e atdhetar, me kohë ishte rreshtuar në radhët e Ushtrisë Çlirimtare

edhe doktor Vezir Bajrami, i lindur në fshatin Raçak (1957) të komunës së Shtimes. Ndihma mjekësore profesionale e dr. Vezirit në luftën tonë të fundit për çlirim nga serbët, kulmoi me shërimin e plagëve të ushtarëve dhe civilëve të plagosur si dhe me identifikimin dhe regjistrimin me emër e mbiemër të të gjithë masakruarve në Raçak më 15 janar 1999, të cilat fakte iu dhanë William Vokerit, që ishte i pranishëm pak pasi ndodhi kjo ngjarje makabre nga forcat paramilitare, policore dhe ushtarake serbe.

Liria e asnjë populli nuk gjendet në kufizime të drejtësisë, dhe as e kontrolluar siç do e dëshironim të gjithë popujt e robëruar, pa dallim. Lajmi mori botën. Raçaku, të gjithë banorët e tij, të gjallë e të maskuar; me një fjalë

e gjithë Kosova dhe populli i saj, u bënë temë botërore; u bënë shpirtira njerëzore për të cilët luteshin gjithandej globit! Më në fund, doli në pah e vërteta e fytyrës serbe në të gjithë botën. Më kot mundoheshin ta paraqitnin veten si komb i qytetëruar. Gënjeshtrave të tyre u erdhi fundi. William Voker, i dërguari i OSCE-së, e tha përpara mediave botërore, se në Kosovë, përkatësisht në Raçak ka ndodhur gjenocid kundër njerëzimit! Bota e qytetëruar e ndjeu, e pa dhe ndërmori masat. Serbia shumë shpejt do të gjuhëzohet përpara Aleancës më të madhe botërore, e udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës!

Është e dhimbshme ajo që ndodhi në Raçak dhe në Kosovë atëkohë, nga Serbia. Efektet e hidhura të asaj masakre i kemi

të freskëta ende në memorien tonë kombëtare!

Ishte i madhërishtëm organizimi luftarak i UÇK-së dhe bashkëpunimi i saj me aleatët perëndimor, si asnjëherë tjetër më parë, në historinë tonë shumë shekullore.

Fituam. Liria erdhi si shpagim i gjakut të derdhur të shumë bijve e bijave tona.

Prekazi legjendar, po ngrihej me shpejtësi si një vend i shenjtë i kombit tonë.

Raçaku nga ajo Natë e Bartolomeut, u shndërrua në një vend pelegrinazhi për të kujtuar e për të mos e harruar gjenocidin edhe të shumë shekujve tjerë, që rëndon tepër shumë në kujtesën tonë gjithëkombëtare.

Lavdi të gjithë të rënëve për liri!
Prishtinë, 15 janar 2020



Fizika dhe kimia simetrike, udhëtim drejt universit (2)

Ngjashmëria në mes të skajeve të poleve magnetike



Shkruan: Naim KRASNIQI, fizikan

Argument i dytë

Tërësisht ngjashëm edhe në këtë pjesë eksperimentale shihet qartë se ka një simetri në mes të dy poleve magnetike, sikur te fusha magnetike e polit magnetik të veriut (N) ashtu edhe te fusha magnetike e polit magnetik të jugut (S). Prandaj siç po shihet eksperimentalisht nga ky eksperiment fusha magnetike qenka simetrike edhe në pjesën anësore të poleve magnetike të një magneti. Që është një argument se fusha magnetike e një magneti është simetrike mbi të dy polet, dhe buron njëkohësisht nga të dy polet e magnetit e cilit do magnet.

na bëhet e mundshme të vërehet qartë se fijet e hekurit nuk janë të radhitura në një vijë drejtvijore ashtu sikur duhej të ishte, që do ta vërtetonte se fusha magnetike buron nga poli magnetik i veriut (N) dhe hynë në polin magnetik të jugut (S). Zakonisht nëse i marrim magnetet qoftë në formë të cilindrave apo në formë të sferave, kanë prirje që të tërhiqen nga polet magnetike ashtu sikur shihet në figurën 2. b), dhe të mos mbetet ndonjë ndërprerje në mes poleve magnetike, ashtu sikur shihet mbi një pjesë të fijeve të hekurit mbi sipërfaqen e magnetit cilindrik. Kështu që zbrazëtirat në mes këtyre fijeve të hekurit përmbi trupin e magnetit tregojnë qartë se fusha magnetike buron nga të dy polet magnetike, dhe në forma të njëjta.

Ngjashmëria në mes gjysmëpjesëve të poleve magnetike

Argument i tretë

Pasi fijet e hekurit nuk janë të radhitura në mënyrë zinxhurore,




Fig 2a

simetrike nga të dy polet magnetike (N) dhe (S) në drejtime të kundërta me njëra tjetrën. Prandaj në këtë mënyrë fushat që burojnë nga të dy polet magnetike si të veriut (N) ashtu edhe të jugut (S) quhen fusha magnetike simetrike.

Fusha magnetike simetrike

Fushat magnetike simetrike janë fusha që burojnë njëkohësisht nga të dy polet e një magneti apo elektromagnetit.

Anomalia e rrjedhjes së fushës magnetike

Duke u bazuar në të dhënat eksperimentale nga të cilat vihet në përfundim se, fusha magnetike nuk buron nga poli mag-

trike, sikurse janë elektronet në lëvizje, merret ashtu sikur e njeh fizika tani për tani, edhe pse të kuptuarit e këtyre bartësve të rrymës elektrike mund të ndryshojë në të ardhmen (këtë paralajmërim e bëj mbështetur në faktin se jam duke bërë shumë eksperimente që më sugjerojnë ndryshime, të cilat rezultate do t'i publikojë në kohën e duhur). Meqenëse në rastin e parë u orientova në fushën magnetike të një magneti permanent, tani në rastin e dytë do të orientohem në fushën magnetike e cila krijohet nga rryma elektrike. Dihet botërisht se rreth një përcuesi nëpër të cilin kalon rryma elektrike, formohet fusha mag-

gishtave që e mbështjellin përcuesin. Në anën e poshtme të përcuesit gjilpëra magnetike merr një drejtim, ku poli i veriut (N) ndodhet në anën e majtë, kurse poli magnetik i jugut (S) ndodhet në anën e djathtë, çka do me thënë se fusha magnetike lëviz nga e djathta në të majtë në drejtim të përcuesit. Kurse mbi përcues gjilpëra magnetike merr drejtim të kundërt me rastin mëparshëm, në këtë rast poli magnetik i jugut (S) orientohet në anën e majtë të përcuesit, kurse poli magnetik i veriut (N) orientohet në anën e djathtë të përcuesit, çka do me thënë se fusha magnetike lëviz nga e majta në të djathtë në drejtim të përcuesit (ashtu sikur shihet në figurën 3. b).

Fusha magnetike në brendi të një solenoid

Në rastin e tretë, tani e marrim një solenoid nëpër të cilin kalon rryma elektrike. Rryma e cila kalon nëpër përcuesin në formë solenoidi e formon fushën magnetike në brendi të tij. Këtu përdoret rregulla e dytë e dorës së djathtë, ku gisht i madh tregon kahen e lëvizjes së fushës magnetike. Prandaj fusha magnetike lëviz nga poli magnetik i jugut (S) në drejtim të polit magnetik të veriut (N) (ashtu sikur shihet në figurën 3. c). Por nëse në brendësi të solenoidit e vendosim një gjilpërë magnetike, shihet se poli magnetik i veriut (N) i gjilpërës magnetike orientohet në drejtim të polit magnetik të jugut (S) të solenoidit, kurse poli magnetik i jugut (S) i gjilpërës magnetike orientohet në drejtim të polit magnetik (N) në brendësi të solenoidit. (VIJON)




Fig. 3a

Analiza e pestë, e vërtetshme nga komuniteti shkencor

Tani e marrim vetëm pjesën e trupit të magnetit në shqyrtim. Nga fotografia shihet qartë se pluhuri i hekurit është koncentruar mbi trupin e magnetit ashtu sikur shihet në figurën 2. a). Mesin e magnetit ku pluhuri është më i dendur, nëse rritet do të shohim se nuk ekziston asnjë vijë e fushës magnetike e pandërprerë, që nisat nga poli magnetik i veriut (N) dhe shkon në polin e jugut magnetik (S) ashtu sikur shihet në të njëjtën figurë.

Gjithashtu shihet se ka një simetri tërësisht të njëjtë në mes gjysmë pjesës (a) të polit magnetik të veriut (N) dhe gjysmëpjesës (b) të polit magnetik të jugut (S). Kurse një detaj i tjetër shihet nëse e rrisim fotografinë,



Fig.3b

me ç'rast do të vazhdonin nga poli magnetik i veriut (N) në drejtim të polit magnetik të jugut (S) në formë të një vije të pandërprerë, është një tregues i qartë se edhe nga poli magnetik i jugut (S) buron fusha magnetike, ngjashëm sikur nga poli magnetik i veriut (N).

Konkludim

Bazuar në këto fusha simetrike që i sqaruam, ku shihet një ngjashmëri totale në mes këtyre fushave qoftë mbi polin magnetik të veriut (N) prej nga pretendohet se buron fusha magnetike, qoftë mbi polin magnetik të jugut(S) prej nga pretendohet se hyn fusha magnetike japim një përfundim eksperimental. Fusha magnetike buron njëkohësisht nga të dy polet magnetike, sikur nga poli magnetik i veriut (N) ashtu edhe nga poli magnetik i jugut (S), dhe shpërndahen në formë

netike. Çka do me thënë se lëvizja e elektroneve nëpër një përcues krijon fushën magnetike rreth përcuesit. Rregulli i parë i dorës së djathtë thotë, nëse e kapim një përcues me dorën e djathtë, gisht i madh tregon drejtimin e lëvizjes së rrymës elektrike, përkatësisht drejtimin e lëvizjes së elektroneve nëpër përcues, kurse gishtat e tjerë tregojnë drejtimin e fushës magnetike figura 3. a). Po ta afrojmë një gjilpërë magnetike, ajo merr drejtimin e




Fig.3c

Fusha magnetike e përcuesit elektrik

Sqarim: bartës të rrymës elek-

POPULLI I GJILANIT NDERON DHE BËN HOMAZHE ME RESPEKT TË THELLË HEROIN E KOMBIT XHEVAT QERIMI!



Nga Ndue DODAJ

Një ditë e veçantë data e 10 janarit 2020 jo vetëm për popullin e Gjilanit por për të gjitha hapsirat mbarëkombëtare shqiptare sepse ishte një ditë, që si sot e 27 vite më parë, ka qenë një ditë dhimbje e thellë për humbjen e madhe e të jashtëzakonshme të shokut të dashur e të shtrenjtë Xhevat Qerimi, e kjo ditë e 10 janarit 2020 ishte një ditë dhimbje dhe krenarie njëkohësisht.

Edhe koha ishte me diell, si të ishte vërtetë një ditë pranvere, kjo ndodhte sepse Heroi i Kombit Xhevat Qerimi sot do të ishte në mesin e popullit që e priste në Gjilan për ta përcjellë me nderime e respektin më të lartë për tu prehur në varrezat e dëshmorëve të Gjilanit sëbashku me dëshmorët dhe heronjtë e tjerë të kësaj zone.

Që në orët e para të mëngjesit qendra e qytetit kishte një pamje tjetër sepse pas 27 vitesh mungese, sot do të priste në gjirin e saj birin e lavdishëm, Heroin e Kombit Xhevat Qerimin dhe njerzit kishin filluar të grumbulloheshin në sheshin e qytetit ku ndodhen dhe shtatorët e

Republikës së Kosovës sëbashku me stafin e tij, vjen Fatime Ahmeti Kryetare e Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të Gjilanit, ndërkohë dhe bashkëshortja e dëshmorit të parë të Zonës së 6-të Operative Anamoravës Pajazit Ahmeti, vjen sekretari i kësaj shoqate Muhamet Bilalli njeri prej inisitorëve të kësaj ceremonie, Xhevdet Mehmeti Kryetari i Shoqatës së Veteranëve të UCK-së për Gjilanin, Agim Myrtaj Kryetar i Shoqatës së Invalidëve të UCK-së për Gjilanin, vjen me karricë Minush Luma Invalidi i Luftës së UCK-së i cili ka qenë shok i Heroit Xhevat Qerimi me të cilin është stërvitur në Surrrel të Tiranës në tetor 1991.

Me të gjithë shtërngojmë duart dhe përqafohemi si vëllezër të vërtetë. Dhe ja vjen ora e shumëpritur 11.00 kur arkivoli me eshtrat e Heroit të Kombit Xhevat Qerimi vendoset përballë hyrjes së Pallatit të Kulturës të Gjilanit mbi një piedestal të lartë i mbuluar me Flamurin Kombëtar, ku në ballë të këtij piedestali është vendosur një portret i Heroit me një pamje gjidande e përballë tyre si një tip fushë me lule të mrekullueshme dhe e gjithë rruga dhe shkallët me tapet të kuq.

Në krye qëndron Flamuri Kombëtar. Vërtetë dhimbje, emovion e krenari për të gjithë të pranishmit, kur njerzit me një rregull admirues e të vecantë fillojnë të ecin kokëulur duke shkuar përballë arkivolit që nderohet nga truproja e nderit, ku bëjnë roje nderi pastaj ashtu në kolonë për një

Përkujtimore që do të zhvillohej për këtë hero.

Tek fytyrat e secilit prej tyre konstatohej dhe një farë dhimbje e trishtimi por dhe një krenari e jashtëzakonshme për dashurinë e zjarrtë e të pakufishme që kishin për këtë hero në vecanti, për atë që pikërisht sot po ndodhte mrekullia që dhe ky hero po vendosej në Panteonin e Lavdisë pranë Heronjëve të tjerë të Atdheut, pranë varrezave të Gjilanit.

Të gjithë të pranishmit përkulen me nderimet më të mëdha e respekt të jashtëzakonshëm, ku radha e njerzve nuk ka të mbaruar e për këtë

udhëheqësve të LPRK Ismet Sylejmanin.

Në fjalën e tij Ai nuk la pa falenderuar dhe për pjesëmarrje të gjithë të pranishmit duke filluar me Shqipërinë amë, të Maqedonisë e të Kosovës Lindore. Fjala e tij u dëgjua me vëmendje dhe u duartrokoi nga të pranishmit.

Më pas iu dha fjala Ahmet Isufit, Komandantit të Zonës 6-të Operative të Anamoravës që do të fliste më së shumti për vlerat dhe veprimtarinë e Heroit.

Pastaj e mori fjalën Izmi Zeka

sishëm kombëtar shqiptar, falenderoj të gjithë të pranishmit.

Në përmblyllje të kësaj Akademie përshëndeti në emër të familjes Qëndresa Qerimi vajza e Heroit.

SHENIM: Nga gëzimi i madh që mu krijua në këtë Akademi në shiritin e memorjes së mendjes time më erdhën shumë mendime që me zemër disa herë jam nisur për të mbajtur një fjalë rasti, kështu ma thoshte jo vetëm mendja por po ma diktonte dhe zemra.

E megjithatë unë po e postoj këtu atë fjalë të pambajtur.



dhe orari i përcaktuar nuk do të zbatohet sepse para arkivolit të Heroit do të kalonin të gjithë pjesëmarrësit e pranishëm.

Ishte programuar që në orën 12.00 të fillonte Akademia Përkujtimore për Heroin e Kombit Xhevat Qerimin por si rezultat i pjesëmarrjes së shumtë të njerzve që kishin ardhur nga të gjitha anët e shqiptarisë duheshin respektuar të gjithë. Aty nuk ishte vetëm Gjilani, Kamenica, Vitia por aty ishin nga e gjithë Kosova, ishin nga Maqedonia, nga pjesa Lindore, ishte Prishtina e Drenica Heroike, ishte Mirdita e Bardhok Bibës e Kruja e Gjergj Kastriotit, ishin deputete, ministra e zv/ministra, ishte Xhavit Jashari Kryetari Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të Kosovës me stafin e tij, ishte jo vetëm Kryetari Komunës së Gjilanit por dhe ato të Kamenicës e Rahovecit, ishte dhe Akan Lika luftëtari i tre luftërave dhe Invalid I Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ishte dhe Xhavit Isaku ish luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare nga Komuna e Harashinës.

Ndërkohë që salla e Pallatit të Kulturës mbushet plot e përplot si rrallë herë vjen momenti i fillimit të Akademisë Përkujtimore e cila fillon me ekzekutimin e Himnit Kombëtar nga të rinjtë e Shkollës së Muzikës së Gjilanit. Më pas interpretohen dhe disa pjesë operistike.

Në podium do të dalë Gëzim Bimbashi i cili do tja japë fjalën Kryetarit të Komunës së Gjilanit Lutfi Hazirit i cili në fjalën e tij do të evokonte të gjithë jetën dhe veprimtarinë patriotike e atdhetare të Heroit Xhevat Qerimi, ku Ai do të fliste dhe për punën dhe veprën e njerit prej shokëve më të ngushtë, e njeri prej

Zv/Ministër i Punëve të Brendshme që foli dhe si bashkëveprimtar i Heroit duke evokuar punën dhe veprimtarinë e Heroit ku ndë të tjera do të shprehej se: Nga ky refleksion Xhevat Qerimi paraqet në mënyrë emblematike historinë më të re të Kosovës, paraqet mendjen, artin e luftës dhe të ardhmen e ndritshme të Kosovës, prandaj edhe bashkëveprimtari i i tij Ismet Sylejmani ashtu do ta përshkruaj: "Heroi Xhevat Qerimi bën pjesë në grupin e atyre shokëve e bashkëveprimtarëve, në mesin e prijësve e udhëheqësve të luftës ilegale për liri, që çdo ditë të aktivitetit të jetës së Tij, e zhvillonte për përgatitjen e kushteve dhe rrethanave për fillimin e përgatitjeve të luftës së armatosur çlirimtare në Kosovë, si mjetin e fundit e të domosdoshëm për çlirim definitiv nga zgjedha pushtuese serbe". Më pas foli dhe Nazmi Beqiri Zëdhënësi i UCK të Maqedinisë. Akademienë Përkujtimore e përshëndeti dhe Xhavit Jashari i cili foli për jetën dhe veprën e Heroit, falenderoj organizatorët e këtij eventi të rëndë-

EMRI I XHEVAT QERIMIT DO TE GJENEROJE NE HISTORI SI HERONJTE E MEDHENJ TE KOMBIT TONE

I nderuar Qytetar i Parë i Gjilanit Lutfi Haziri!

E nderuara familje e Heroit të Kombit Xhevat Qerimi!

Të nderuar deputete, ministra, zv/ministra!

Të nderuar Kryetarë të Komunave Kamenice e Rahovec!

I nderuar Kryetar Shoqatës Familjeve të Dëshmorëve të Kosovës Xhavit Jashari!

Të dashur vëllezër e motra!

Si ushtarak i Republikës së Shqipërisë më lejoni që në këtë Akademi tju përshëndesi.

Shkak për të marrë fjalën e për tju thënë dy fjalë zemre ishin së pari vecantia e kësaj Akademie dhe kjo pamja përballë ku shohim dy portrete. Njera e Gjergj Kastriotit dhe tjetra e Xhevat Qerimit dhe kjo foto e bërë pikërisht tek Kalaja e Gjergj Kastriotit pikërisht në muajin tetor të vitit 1991 kur Xhevati do të vizitonte këtë Kala kur do të stërvitej në Surrrel.



Heronjëve të Kombit Rexhep Male e Nuhi Berisha si dhe para Pallatit të Kulturës ku është dhe shtatorja e Heroit Agim Ramadani. Njerzit grumbullohen para kohe për të nderuar Heroin e tyre, ku shikohet se të gjithë vinin kokëulur me peshën e dhimbjes por dhe krenar për njeriun që do të nderonin.

Ndër të parët në këtë shesh për të bërë pritjen dhe nderimet e rastit vijnë shokët dhe veprimtarët ilegalë me të cilët kishte bashkëpunuar Heroi. Vijnë aty ish udhëheqësit kryesorë të LPRK shokët Emrush Xhemajli, Hydajet Hyseni, Ismet Sylejmani, vjen Ahmet Isufi Komandanti i Zonës së 6-të Operative Anamoravës, vjen Xhevat Jashari Kryetari i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të

drejtohen në drejtim të pjesëtarëve të familjes të cilët janë të rreshtuar në të majtë të arkivolit dhe takojnë me radhë vajzat e Heroit të Kombit Jetmirën dhe Qëndresën, motrat Margaritën, Teutën e Sheqeren, vëllezërit Qemajlin e Ramizin, bashkëshorten dhe shoqen e idealit Imrien, nënën Rexhije dhe babain Batriun. Në mesin e tyre qëndronte dhe një nip i vogël i Heroit, me kostumin e ushtarit të UCK-së që aq shumë i shkante, djali i Qëndresës me një emër madhështor KOLOS.

Secili në heshtje pret radhën dhe bën homazh para arkivolit që nderojnë truprojet dhe më pas u japin dorën të gjithë pjesëtarëve të familjes Qerimi për tu drejtuar për në sallën e madhe të Pallatit të Kulturës për tu bërë pjesë e Akademisë

Dhe në pllakatën e shkruar me aq mjeshtëri e zgjuarsis ku thuhet: LIRIA E PERJETSHME ESHTË NENA E DESHMOREVE.

Një binom krenarie e lavdie njëherësh që sipas konceptit tim vetëm një njeri me vlera të rralla kombëtare, vetëm një njeri mendje ndritur me shkëlqimin dhe rezatimin e diellit, vetëm një zemër zjarrtë me një emër i cili askush më tepër se sa Ai nuk din të vlerësojë Dëshmorët dhe Heronjtë e Kombit tonë dhe Ai e ka një emër e Ai quhet Ismet Sylejmani, të cilin publikisht e përshëndesi dhe e uroj për këto mrekullira e vlerësime që bën. Kur më ka folur mbi jetën dhe veprën e këtij ilegali të madh të kombit shqiptar, me të vërtetë më është dukur një histori e gjallë.

Veprimtarinë e atdhetarit të shquar Xhevat Qerimi e kam mësuar nëpërmjet shpjegimeve e shkrimeve që janë bërë më parë nga Ismet Sylejmani. Nëpërmjet këtij unë kam njohur këtë njeri me energji të pashtershme dhe me një horizont të gjërë, të cilit po i bëhet kjo Akademi me madhësi. Cilësitë e këtij Heroi që po përkujtojmë do të viheshin re dhe do të njiheshin nga të gjithë ato persona që e kanë njohur nga afër.

Krahas shokut, mikut e vëllait Ismet Sylejmanit për këtë Hero më kanë folur dhe ca shokë tjerë. Ndër ta po përmend dhe njerin që ka qënë në një grup me Xhevat në stërvitjen e Surrelit në tetorin e vitit 1991 dhe ky është Ramadan Dani Pajazit i cili më ka thënë se Xhevati ishte njeri nga personat më strikt dhe ishte tepër i angazhuar në stërvitjet ushtarake, kishte një shoqëri me të gjithë shokët, pa bërë asnjë dallim dhe vecoria e të gjithëve ishte se Xhevat in e donin, e respektonin dhe e admironin të gjithë pjesëtarët e grupit.

Sic u përmend dhe nga parafolësit në këtë Akademi, për kuadrot ushtarake që kanë përgatitur grupet e ardhura nga Kosova në Tiranë, unë po sjelli dhe dy raste të tjera që kanë folur për këtë hero, e konkretisht në një takim që kemi zhvilluar unë dhe Nazmi Cela që ka qënë Komandant i kësaj Qendre Stërvitje deri në momentin e ardhjes së grupeve të Kosovës në një takim me mësimdhënës të Kastriot Hoxha tashmë i ndërjetë para disa ditësh nga një sëmundje e rëndë, na ka folur shumë për energjitë e pashtershme dhe për vullnetin e hekurt që kishte Xhevat Qerimi. Po kështu dhe njeri prej ushtarakëve i cili në cdo veprimtari ka patur lidhje me të e konkretisht magazinieri i kësaj Qendre Stërvitje Hysni Lila i cili i ka furnizuar ma armatim, municion, veshmbathje dhe me të ngrënë e të pirë tre herë në ditë, ku me të gjithë ka patur kontakte jo më pak se mbi pesë herë në ditë, dhe Hysniu do të tregonte për Xhevat in se në këndveshtrimin tim ishte njeri prej djemve më energjik dhe i etur për tu përgatitur sa më shumë dhe sa më mirë, tek ai spikatnin tiparet e një luftëtari të papërkultur, ishte një njeri energjik, ishte një njeri i talentuar i cili me sjelljet dhe veprimet e tij ngrinte peshë dhe mobilizonte të gjithë të pranishmit për të përvetësuar sa më shumë programin e stërvitjes, e thënë ndryshe dhe në



paraqitje ishte një syshqiponjë. Emri i Xhevat Qerimit do të gjenerojë në histori sëbashku me Gjergj Kastriotin, Abdyl Frashërin, Ismail Qemalin, Bajram Currin, Azem e Shote Galicën, Enver Hoxhën, vëllezërit Gërvalla, Kadri Zekën, Afrim Zhitia, Fahri Fazllia, Rexhep Mala, Nuhi Berisha, Adem Jashari, Fehmi e Xhevë Lladrovci e tjerë. Ai është një njeri i papërkulturueshëm që jo rastësisht do të zgjidhej drejtues kryesor i LPRK për Gjilan, Kamenicë e Viti e më pas do të dërgohej në moshën 26 vjeçare në stërvitje në Tiranë për tu përgatitur për komandant për Anamoravën.

E sot që pata fatin e madh që të jem pjesë e kësaj Akademie Përkujtimore ku në pankartën e vendosur në këtë sallë, Xhevat Qerimi, sy shqiponjë më ngjan me një MAL, si një luftëtar i madh, si një patriot me shpirt liri-dashës. E sot ky shqiptar i madh po më duket sikur e shoh në këmbë dhe

në mendje vargjet e një poeti ku për Atdheun ka shkruar:
*Se vinte thinjë e nënës e më thosh...
A je gjallë
Dhe Xhevati do përgjigjej...
Po në përjetësi
Se vinte sy I motrës e më thoshte..... A je ushtar.
Dhe Xhevati do të përgjigjej... Në vazhdimësi.
Se vinte ky plis dheu e më thosh..... Nga varri ngreu
Dhe Xhevati do përgjigjej...
Në gatishmëri jam.
Se jam motra, jam nëna, jam baba jam ATDHEU.*

Dhe për FLAMURIN e kush më bukur se Halim Laci do shprehej:
*S'është larosh me vija anash
Por i kuq me gjak djemsh nënash
E për këtë flamur që u la me gjak
Me gjak do ta mbrojmë
E besnik deri në vdekje do ti qëndrojmë.*

Xhevat Qerimi ishte dhe mbetet një flamur i gjallë që fliste dhe flet e do të flasë edhe në të ardhmen dhe do të ndriçojë e zbukurojë paisazhin e jetës sonë. Që nga sot dhe de juro Xhevat Qerimi është midis nesh në udhëheqje e veprim me pjekurinë, guximin, trimërinë, me vullnetin historik dhe atdhedashurinë. Gjaku i shqiptarëve të Kosovës është derdhur dhe ka spërkatur deri edhe yjet e qiellit me forma e mënyra të ndryshme si me vrasje, me helmime, me aksidente e lloj lloj formash e metodash të sofistikuar të përdorura nga armiku i përjetshëm.

Njerzit e mëdhenj; sipas Viktor Hygoit; ja ngrënë vetes piedestalin; brezat kujdesen vetëm për shtatoren. Kështu ndodhi dhe me Xhevat Qerimin i cili vjen sot pas pothuajse aq vite sa jetoi dhe po aq vitesh sa na mungon sepse Xhevati jetoi 28 vite dhe ka 27 vite që na mungon.

*Lavdi të përjetshme Herojtë te Kombit Xhevat Qerimi!
Lavdi Desmorëve e Heronjëve te Atdheut!*



po qëndron në heshtje nderi e lavdie para njerzve e të gjithë popullit që po e nderon si dhe para Atdheut që aq shumë e deshi, po bën roje nderi para Flamurit Kombëtar, para të cilit që në ditën e parë të 1 tetorit 1991 ishte betuar. Kur përmendi këto dy emra Atdheun dhe Flamurin po më vijnë



GJILANI I JEP LAMTUMIREN BIRIT TË LAVDISHEM XHEVAT QERIMIT

Rruga nga Pallati Kulturës së Gjilanit, në sheshin qëndror ku janë dhe shtatorët e Heronjëve Rexhep Mala, Nuhi Berisha e Agim Ramadani, një popull i tërë shoqëroj për në Panteonin e Lavdisë arkivolin me eshtrat e Heroit të Kombit Xhevat Qerimi.

Kortezhi i përmtoshëm nis për tek Varrezat e Dëshmorëve të Kombit të Gjilanit. I gjithë sheshi, trotuaret dhe rruga është e mbushur plot e përplot, nuk mungojnë as nxënësit e shkollave të mesme as studentët e Universitetit Kadri Zeka të Gjilanit që

het sëbashku me shokët e tij, bashkë me bijtë e bijat më të zgjedhur e të nderuar të popullit.

Çdo veprim kryhet me komandë nga truproja e nderit, arkivoli i tij mbahet mbi supet e truprojes së nderit të cilët hedhin ato hapa të vegjël e të ngadaltë drejt varrit.

Arkivoli me eshtrat e Heroit të Kombit Xhevat Qerimi zbresin në varr. Mbi arkivolin e tij hidhen buqeta me lule nga dy vajzat e tij Qëndresa e Jetmira si dhe nga bashkëshortja Imria.

Mbi atë varr që do të prehet në përjetësi vendoset me një mjet të rëndë pllaka e varrit. Në këto momente të dhimbshme komandon mjetin e rëndë me duar, në heshtje Hajrush Vokshi, pastaj në varr hidhet dhe nga toka që e lindi dhe e mbajti



do të merrnin pjesë në përcjelljen dhe varrimin me nderime të Xhevat Qerimit në Varrezat e Dëshmorëve të Gjilanit.

Dhimbja e rëndë, e jashtëzakonshme por dhe krenari e lavdi për atë që Ai pas 27 vitesh po i bashkohej dëshmorëve dhe heronjëve të idealit të tij.

Varrezat e Dëshmorëve të Kombit të Gjilanit pritën sot njerin prej bijëve më të dashur të saj. Vjen këtu të pre-

vetëm 28 vite. Pas kësaj sipas radhës që urdhërohet nëpërmjet autoporlantit vendosen kurorat në emër të gjithë institucioneve dhe shoqatave të dala nga lufta. Kurora vendosën dhe shokë, miq e familjarë të heroit Nje kurorë vendosa dhe une me mbishkrimin:

**LAVDI XHEVAT QERIMI!
NGA NENA SHQIPERI
KU U STERVITE TI**



Rohani bën thirrje për unitet kombëtar në Iran

TEHERAN, 15 JANAR - Presidenti i Iranit, Hassan Rohani, bëri thirrje për unitet kombëtar, në kohën kur ky vend po përballet me protesta, për shkak të rrëzimit të një avioni ukrainas të pasagjerëve, një javë më parë. Mbrojtja ajrore e Iranit ka qëlluar avionin e pasagjerëve vetëm pak orë pasi ka goditur bazat amerikane në Irak, në shenjë hakmarrjeje për vrasjen e komandantit iranian, Qasem Soleimani, në një sulm të

ShBA-së, më 3 janar.

Irani e ka pranuar përgjegjësinë për rrëzimin e avionit disa ditë më vonë, gjë që ka çuar në shpërthimin e protestave kundër regjimit.

"Njerëzit duan të jenë të sigurt se autoritetet i trajtojnë ata me sinqeritet, integritet dhe besim", tha Rohani në një fjalim televiziv të mërkurën.

Ai iu bëri thirrje forcave të armatosura "të kërkojnë falje" dhe t'i shpjegojnë popullit se çfarë ka ndodhur në tragjedi.

Fluturimi PS752 është rrëzuar pasi është nisur nga Teherani më 8 janar. Të 176 njerëzit në bord kanë humbur jetën. Shumica e viktimave kanë qenë shtetas iranianë dhe kanadezë.

Ministri i Jashtëm i Iranit, Mohammad Javad Zarif, tha po ashtu të mërkurën se njerëzit po protestojnë "kundër faktit se ata janë gënjyer për disa ditë".

"Njerëzit bëjnë gabime, gabime të pafalshme. Por, kjo



ka ndodhur në kohë krize. Duhet të sigurohemi që krizat e tilla të parandalohen", tha Zarif.

Ai më pas e lavdëroi ushtrinë e Iranit për, siç tha, guximin për të pranuar përgjegjësinë.

Demokratët thonë se kanë prova të reja kundër Trumpit

Demokratët në Dhomën e Përfaqësuesve të ShBA-së thanë se kanë zbuluar prova të reja - dokumente përfshijnë tekst-mesazhe dhe shënime me shkrim të Rudy Giulianit, që është avokat i Trumpit

UASHINGTON, 15 JANAR - Demokratët në Dhomën e Përfaqësuesve të Shteteve të Bashkuara thanë se kanë zbuluar prova të reja që lidhen me procedurat për shkarkimin e presidentit Donald Trump.

Ata publikuan disa dokumente që lidhen me akuzat se Trump i ka bërë presion Ukrainës për të hetuar një rival të tij politik.

Këto dokumente përfshijnë tekst-mesazhe dhe shënime me shkrim të Rudy Giulianit, që është avokat i Trumpit, raporton BBC, ka njoftuar voa.

Trump i mohon akuzat, ndërsa hetimet kundër tij i quan "gjueti shtrigash"

Demokratët thanë se do t'i dërgojnë provat e reja - të siguruar nga biznesmeni Lev Parnas - në Senat, së bashku me akuzat formale kundër Trumpit.

Dhoma e Përfaqësuesve do të votojë të mërkurën për dërgimin e akuzave në Senat.

Pasi demokratët e kontrollojnë Dhomën, votimi pritet të jetë

pro.

Kur akuzat kalojnë në Senat, ky i fundit mund të nisë me gjykimin e presidentit.

Demokratët, deri më tash, nuk i kanë dërguar akuzat në Senat, pasi Partia Republikane - së cilës i përket edhe presidenti - ka refuzuar të lejojë pjesëmarrjen e dëshmitarëve në gjykim.

Trumpi akuzohet për shpërdorim të detyrës dhe pengim të punës së Kongresit.

Dhoma e Përfaqësuesve i ka ngritur akuzat formale kundër tij në muajin dhjetor.

Nëse gjatë gjykimin në Senat shpallet fajtor - gjë që thuhet se ka pak gjasa pasi ky institucion kontrollohet nga republikanët - Trumpi do të shkarkohet nga detyra.

Trumpi akuzohet se i ka bërë presion Ukrainës për të zbuluar informacione të dëmshme për Joe Bidenin, i cili mund të jetë rival i tij në zgjedhjet e nëntorit.

Në këmbim të favoreve nga Ukraina, Trumpi akuzohet se ka



mbajtur dy gjëra pezull: ndihmën ushtarake për Ukrainën, në vlerë prej 400 milionë dollarësh, dhe një takim në Shtëpinë e Bardhë me presidentin ukrainas.

Me këto veprime, sipas demokratëve, Trumpi ka abuzuar me pushtetin, pasi ka përdorur zyrën e presidentit për përfitime politike personale dhe

në dëm të sigurisë kombëtare. Trumpi akuzohet edhe për pengim të punës së Kongresit, pasi ka refuzuar të bashkëpunojë në hetime.

Putini emëron kryeministrin e ri

MOSKË, 15 JANAR - Kremli bëri të ditur se presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, ka emëruar shefin e Shërbimit Federativ të Taksave, Mikhail Mishustin, për kryeministër të ri të Rusisë.

Ky veprim erdhi vetëm pak orë pasi Dmitry Medvedev dhe qeveria e tij dhanë dorëheqje, në përgjigje të thirrjes së Putinit për ndryshime të mëdha kushtetuese. Mishustin, 53 vjeç, ka punuar në Qeverinë ruse qysh në vitin 1998.

Ai ka mbajtur një profil të ulët si shef i Shërbimit Federativ të Taksave - pozitë që ka mbajtur qysh në vitin 2010. Mediet ruse raportojnë se Putini e ka dërguar

kandidaturën e Mishustinit në parlament për miratim. Të mërkurën, presidenti rus, gjatë fjalimit vjetor drejtuar kombit, bëri thirrje për ndryshime të mëdha kushtetuese, që do të rrisnin kompetencat e parlamentit, përpara përfundimit të mandatit të tij, më 2024.

"Në këtë kontekst, ne, si Qeveria e Federatës Ruse, duhet t'ia sigurojmë presidentit të vendit tonë mundësinë për të ndërmarë të gjitha vendimet e nevojshme. Në kushtet e tilla, mendojse Qeveria e Federatës Ruse ka bërë hapin e duhur me dorëheqje", tha Medvedevi, teksa njoftoi për



dorëheqjen. Putin, duke iu adresuar Asamblesë Federale, tha se

Kushtetuta e Rusisë, e vitit 1993, duhet ndryshuar, për t'i dhënë Dumës Shtetërore, që është Dhoma e Ulët e Parlamentit, të drejtën për të emëruar ministrat e kabinetit dhe kryeministrin, raporton Rel.

Këto kompetenca aktualisht i takojnë presidentit. Putini po ashtu tha se Rusia duhet të mbetet "republikë e fuqishme presidenciale". "Presidenti duhet të ruajë të drejtën për të përcaktuar detyrat dhe përparësitë e qeverisë, si dhe të drejtën për të shkarkuar kryeministrin, zëvendësat e tij dhe ministrat federalë, në rast të moskryerjes së detyrave ose

humbjes së besimit", tha Putini.

Ai po ashtu tha se duhen ashpërsuar kushtet për t'u bërë president dhe se çdo president i ardhshëm duhet të ketë jetuar në Rusi për së paku 25 vjet dhe të mos ketë ndonjë shtetësi të huaj.

Vladimir Putin dhe skandalet gjatë 20 vjetëve në pushtet Putin, 67 vjeç, ka dominuar politikën ruse për dy dekada, duke shërbyer herë si president, herë si kryeministër nga viti 1999. Në vitin 2018, ai është rizgjedhur president për një mandat të ri 6-vjeçar.

Me ligjin aktual, ai do të duhet të tërhiqet pas përfundimit të mandatit.

Gjergj Fishta dhe folklori

Nga Tonin ÇOBANI

Improvizimet e para

Fishta, fshat i vogël në Zadrimë, ndërmjet qyteteve Shkodër dhe Lezhë, është emër-vendi i parë i rëndësishëm që lidhet me Gjergj Fishtën. Aty lindi fëmija me emrin Zef (Zefi i vogël), që më vonë do të njihet me emrin e madh Gjergj Fishta. Zefi është fëmija e katërt në vatrën e Ndokës (babai) dhe Prendës (nëna), nga fshati Kotërr/Zadrimë. Ai lindi pas dy vëllezërve (Leka dhe Simoni/Çupi) dhe motrës (Lena). Të katër fëmijët lindën në një shtëpi të madhe prej 96 pjesëtarësh (Gj. Frani), diçka që sot është vështirë të përfytyrohet. Por kjo shtëpi e madhe u shpërbë në fund të shekullit XIX, pikërisht kur Gjergj Fishta ishte rreth të shtatëmbëdhjetave. U shpërbë më pas edhe vatra e Ndokajve: Simoni (ose Çupi) u vra (1899), Leka u nda kësaj bote në kapërcyell të dekadës së dytë dhe të tretë të shek. XX, duke lënë pesë djem dhe një vajzë. Ndërsa Lena ka jetuar më gjatë, rreth të 80-ve. Vdiq në vitin 1948, e pamartuar. Emërvendi i dytë i rëndësishëm është Troshani (shumë pranë fshatit Fishtë), ku ishte ngritur qysh në gjysmën e parë të shekullit XVIII Kuvendi i Françeskanëve, i pari kuvend françeskan në Zadrimë. Madje është edhe para Kuvendit të Arrës së Madhe dhe të Gjuhadorit në Shkodër. Ndoshta, është edhe para Kuvendit të Lezhës, sado që njihet një gojëdhënë që e dëshmon Kuvendin Françeskan të Kishës së Dom Leshit si të bekuar prej vetë Shën Françeskut të Asizit. Në vitin 1871 famullitari i kishës së Troshanit mbulonte me shërbesa fetare edhe banorët e fshatit Fishtë, pra, pagëzon edhe Zefin e sapolindur në konakun e Ndokajve. Ai është një poet që do të ndikojë shumë në formimin kulturor të Zefit/Gjergjit nëpër të gjitha fazat e zhvillimit të tij si poet e dramaturg, si eseist e publicist, si mësues dhe veprimtar për çështjen kombëtare: ai është At Leonardo de Martino, OFM... Por ne le t'i afrohem edhe më pranë vatrës familjare të Zefit të vogël. Të dy vëllezërit dhe motra, Lena, kanë qenë të njohur për talentin e tyre si poetë popullore. Ata kanë dhuntinë e improvizimit të vargjeve të rimuara: në formë replikash në lojërat popullore, si Loja e Kapuçave (Çupi dhe Leka), në formë elegjish në raste mortesh (Lena), në formë urimesh e shpotitjesh në raste festash familjare e shkollore. Për vargjet e fundit shquhej veçanërisht Zefi i vogël, më vonë Gjergj Fishta i Madh. Aftësi të tilla për të

improvizuar me lehtësi vargje të rimuara duhet të kenë pasur edhe prindërit e këtyre fëmijëve. Fishta thoshte për vëllezërit e vet: Medet, po të kishin pasë fatin tim, do të kishin dalë kush e di sa herë ma të mirë se unë: do ma kishin kaluar 'i qind herë (njëqind herë)... Sa për Zefin e vogël dëshmohej prej Pashk Bardhit: fillimet letrare të Gjergj Fishtës janë vargjet e përhendetjeve të tij me raste festash dhe përvjetorësh për bashkëstudentët dhe bashkëkolegët e vet, duke nisur nga viti 1886 kur Gjergj Fishta ishte rreth të 15-tave. "Shokët e tij të kuvendit shkriheshin gazit me vargjet që sajonte aty për aty". (Arshi Pipa) Disa prej këtyre vargjeve kanë qenë ruajtur nga Pashk Bardhi. Disa edhe janë botuar. Diku përmendet edhe një titull libri me autor Fishtën kur ishte seminarist (Bejta të një xhakoni të ri). Por nuk njohim vargje prej tij, ashtu sikundër sot nuk dihet se ku kanë përfunduar vargjet në dorëshkrim, që ruheshin prej Pashk Bardhit.

Botimet e hershme

Ndër miqtë dhe dashamirësit e Fishtës, që kanë mbetur vargjeve të botuara të Poetit të Lahutës, janë, së pari, dy poetë sllavë që njohu ndërsa studionte në Bosnjë-Hercegovinë: (1-ri) poeti françeskan boshnjak Grga Martić (1822-1905), të cilin Fishta e njohu personalisht (dhe i kushtoi një poezi në vitin 1886, serbokroatisht) dhe (2-ti) poeti kroat Silvije Strahimir Kranjčević (1865-1908), me të cilin poeti ynë kishte miqësi (edhe këtij i kushtoi një poezi italisht, më 1892). Ajo është ruajtur, pasi ka qenë botuar më 1933-1934 në vëllimin e veprave të plota të poetit kroat. Ndër shqiptarë përmenden: Lazër Mjeda (1901/11), Anton Xanoni (1908,1915), Faik Konica (1908), Luigi Gurakuqi (1909), Vinçenc Prennushi (1909), Pashk Bardhi (1920) etj. Gjergj Fishta futet kështu në letrat shqipe si një poet i lindur, që improvizon vargje të rimuara me lehtësi. Por vargjet e tij të improvizuara vijnë gjithnjë e më tepër të ngjeshura me ide dhe emocione të fuqishme universale. Vargje të tilla u botuan fillimisht te revista Albania e Faik Konicës: "Kangë malcorisht" (1900/4) "Kangë mirditnish" (1900/6), "Kangë malcorisht" (1900/9), "Kanga e Gjin Lekës" (1901/10), "Kanga e Ndoc Kolës" (1904/6), ndonjëra prej të cilave ka qenë klasifikuar si këngë folklorike, duke qenë se Fishta i kishte nënshkruar me pseudonimin "E popullit". Me këtë pseudonim do të nënshkruhen edhe dy blenet e para të "Lahutës së Malcis" (1904/5, 1907).



A e ka mohuar Fishta autoktoninë e këngëve epike shqiptare

Fishta ka shkruar për folklorin duke nxitur mbledhjen dhe studimin e tij ndër kolegët françeskanë dhe jo vetëm. Sipas Benedikt Demës, ai ka shkruar edhe parathënien e vëllimit të parë të "Visarit Kombëtar, kangë popullore gegnishte, rendue prej A. Vinçenc Prennushit" (Sarajevë, 1911). Ndonjë studiuues tjetër i mëvonshëm, siç është Veis Sejko, në librin e tij "Mbi elementet e përbashkëta në epikën shqiptaro-arbëreshe dhe serbokroate" (2002), ka mbrojtur mendimin se autori i asaj parathënieje nuk është Fishta, por vetë Vinçenc Prennushi, prej të cilit citohet paragrafi që deklaron se në folklorin shqiptar nuk ka këngë epike, pasi do rapsodija e legjenda si b.f. kanga e Mujos dhe Halilit, kanga e Halil Garrisë, kanga e Kalasë së Shkodrës, etj, na duket se janë të përkthyme prej sllavishtes... të gjitha gjinden në literaturë të serbëve dhe kroatëve. (f. 171). Madje, aludohet se ai paragraf është shtuar (dora vetë ose me porosi të tij) nga drejtori i atëherëshëm i Institutit të Sarajevës (serbi Qiro Truheljka), albanolog që nuk dinte shqip. Por ai dinte veçse bozaxhinjtë dhe hallvaxhinjtë prunë epikën boshnjake në Shqipëri (f. 175), prandaj këngët epike të Veriut të Shqipërisë nuk përfshihen në "Visarin Kombëtar" të Prennushit. Ato këngë u fshehën: Sejko beson që po të bëhet një gjurmim i mirë në arkivat e Institutit të Sarajevës për kohën para vitit 1911, mund të gjenden dorëshkrimet e Prennushit mbi

këngët epike malësore shqiptare... Në kapitullin "Dy renegatë të kombit shqiptar" (dhe ata janë Vinçenc Prennushi dhe Stavri Skendi), Sejko argumenton lajthitjen e tyre shkencore si vënie në shërbim të interesave të të huajve. Sidoqoftë, edhe nëse ajo parathënie është shkruar (ose jo) nga Fishta dhe ai paragraf është shtuar (ose jo) nga botuesi, një mendim i tillë për epikën e folklorit shqiptar të Veriut nuk është formulim i Fishtës. Ose ka qenë një konkluzion kalimtar, tepër i përkohshëm. Për këtë sjellim në vëmendje tre fakte. I pari lidhet me një recension të Fishtës në numrin e parë të revistës "Hylli i Dritës" (1913) për librin e Prennushit. Fishta vlerëson rëndësinë historike të folklorit shqiptar (Kangët popullore janë një dokument rëndësie të madhe për historinë) dhe bën vërejtje për shënimet (oroet) e autorit, të cilat po të ishin pak gjatë ma të shpeshta e ma të plota, nuk kishte lanë kurrë mangut për me qenë vlerësuar (njehë), një ndër ma të vlershmet vepra të literaturës kombëtare (Gjergj Fishta, "Vepra letrare 9", f. 24). Fakti i dytë është një vlerësim (në të njëjtin recension) për mjeshtrinë e të shkruarit të parathënies, të cilën Fishta e cilëson si ligjëratë të autorit (Vinçenc Prennushi): Para kangëve dhe valleve popullore, - shkruan Fishta në revistën e tij, - autori ka vu një ligjëratë... (Po aty, f. 24). Pra, jo autori i recensionit (Fishta) e ka shkruar atë ligjëratë (parathënie). Nuk e ka shkruar as një grup fretërisht, si përpigjet të justifikojë mungesën e autorësisë së parathënies, Alfred Çapaliku në monografinë e vet kushtuar Viçenc Prennushit (f. 84). Fakti i

tretë është letra që Fishta ia dërgon albanologut austriak, Nobert Joklit, së bashku me këngët: Martesa e Mujit, Martesa e Halilit, Gjergj Elez Alia dhe Muji e Behuri. Fishta i kërkon një vlerësim ("nji gjyq") për këngët dhe e pyet: A mos gjindemi para ciklit rapsodijash mbetë prej ndonji poetit të madh të vjetër? Kjo pyetje Fishtës i ka lindur pasi ka mësuar se një malësor (Malësia e Madhe) ka pohuar se di rreth 63 rapsodija mbi Mujin e Halilin, e thotë se të gjitha kanë një lidhni ndërmjet vedit (Fishta, "Estetikë dhe kritikë, f.85). Autori i "Lahutës..." as nuk e vë në kandidate mendimin se ato këngë mund të jenë të përkthyer ose jo nga serbo-kroatishtja. As nuk kërkon mbështetje kundër tezës boshnjake që qarkullonte asokohe në shkrimet e studiuësve sllavë dhe jo vetëm. Po, ai shton se rapsodi shqiptar sot gjendet nën Jugosllavi. Konkluzioni (tashmë i qëndrueshëm) për problemin e ngritur është i thjeshtë. Ose Fishta nuk ka menduar asnjëherë se në folklorin shqiptar mungojnë këngët epike, pra edhe parathënia në fjalë (ose vetëm ai paragraf, që konteston Sejko) nuk është shkruar ndonjëherë prej Poetit tonë. Ose, së paku, dy vjet mbase është botuar ajo parathënie, mendimi i shprehur në atë paragraf nuk qëndron më. Aq më pak, qëndron ai mendim në vitin 1926 kur Fishta i shkruan Joklit. Lëre më, të themi, në vitin 1937, kur botohen "Visaret e Kombit 2, kangë kreshnikësh dhe legjenda" të françeskanëve të nxitur prej Fishtës, Benardin Palaj dhe Donat Kurti. Fishta, në një CV të vetën shkruar në italisht e përfshin edhe veten në studimin dhe mbledhjen e folklorit kombëtar shqiptar (Benedikt Dema).

E rrallë

Hedhin nga helikopteri derrin, përfundon i ngordhur në një pishinë të vogël

Një video rrëqethëse që po qarkullon në internet shfaq një grup personash të pan-johur të cilët hedhin nga helikopteri derrin e një milioneri nga Urugai. Në video shihet se si derri bie me shpejtësi të madhe dhe



përfundon në një pishinë të vogël. Federico Alvarez Castillo, 60 vjeç, ka kritikuar ashpër personat që e kanë bërë këtë vepër, madje është zotuar se do t'i gjejë ata dhe do të hakmerret.

FOTO E DITES



Njëzet e një vjet më parë, më 15 janar 1999, forcat serbe në Reçak ekzekutuan mizorisht 45 civilë shqiptarë, të të dy gjinive dhe të gjitha moshave

E jashtëzakonshme

Shkencëtarët krijojnë arin plastik

Një grup shkencëtarësh nga ETH Cyrih i Zvicrës kanë vendosur se si të prodhojnë ar në laborator. Ari i tyre peshon pesë deri në 10 herë më pak se ari tradicional 18 karat dhe mund të përdoret për të zbukuruar bizhuteri që do ta ruanin vlerën e tij, por do të ishin dukshëm më të lehta. Përzierja klasike e arit 18 karatësh është e përbërë nga tre të katërtat e arit dhe një të katërtën e bakrit, ari i



ri është bërë me fije proteine dhe polimere të lateksit për të krijuar një matricë që mbyll disqet e hollë të nanokristalëve të arit.

BARSOLETA E DITËS



Në Gjirokastër një profesor kimie pyet nxënësit:
- Nëse e vë orën time të dorës në këtë enë të mbushur me element kimik, si mendoni ju, do të shkrihet?
Një nxënës i përgjigjet:
- Jo.
- Shumë mirë. Si e nxore këtë konkluzion?
- Shumë e thjeshtë profesor, nëse do të shkrihej ju nuk do ta fusnit kurrë orën tuaj të dorës aty brenda!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

Rolet: Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

Regjia: Troy Quane, Nick Bruno



Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.

Regjia: Jake Kasdan




Çdo natë në ora 20:00 STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

Rolet: Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj

Regjia: J.J. Abrams




Çdo natë në ora 22:30 THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

Rolet: Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

Regjia: Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).

<p>DASHI Gjatë gjithë ditës do të jeni të zënë me punë. Ajo do të jetë e këndshme dhe e paguar mirë.</p>	<p>DEMI Bëni gjithçka që të keni mundësi të argëtoheni, shfrytëzoni çdo shans që ju vjen. Jeta si çift kthehet në magjepsëse.</p>	<p>BINJAKËT Shmangni përplasjet kokë me kokë, humbja është e garantuar! Përdorni disa kura bimore për qetësinë e mendjes dhe një njohuri më të thellë për brendësinë e dikujt.</p>	<p>GAFORRJA Sot do të kaloni një ditë shumë të mirë dhe do të jeni një nga shenjat më të preferuara të zodiakut.</p>	<p>LUANI Ditë ideale për të bërë një banjë të ngrohtë në shtëpi dhe të relaksoheni, apo të bëni ndonjë blerje interesante për ta zbukuruar dhe ta bërë të rehatshme atë.</p>	<p>VI RGJËR ESHA Ditë e favorshme për shoqërinë dhe miqtë e rinj. Do ta keni mundësinë për ta përmirësuar pozicionin tuaj socio-profesional.</p>
<p>PESHORJA Familja ka një ndikim të madh sot tek ty, por në thelb e kuptoni që ajo po ju bllokton.</p>	<p>AKREPI Hëna dhe Merkuri ju përvetësojnë me entuziazëm: nuk jeni në gjendje të shihni anën negative të situatave!</p>	<p>SHIGJETARI Mundohuni t'i moderoni instinktet tuaja dhe të jeni pak më i ndjeshëm: Me siguri do të keni një jetë më paqësore përpara.</p>	<p>BRICJAPI Ka shumë muhabet të brendshëm që po ndodh në trurin tuaj dhe mund të mos kenë kuptim shumë për ju.</p>	<p>UJORI Pritja e gjatë shpërblehet përfundimisht nga kalimi i Hënës në fushën tuaj: tani gjithçka bëhet më e lehtë, madje edhe gjetja e zgjidhjes së duhur për një çështje të ndërlikuar financiare.</p>	<p>PESHQIT Idealja do të ishte zgjidhja e çështjeve të ndenjura, edhe nëse kërkojnë kohë dhe qetësi.</p>

Alketa, moderatore e festivalit më të rëndësishëm në Itali



Alketa Vejsiu do të realizojë atë që nuk e ka bërë asnjë moderator tjetër shqiptar: do ta prezantojë Sanremo e këtij viti krahas emrave të njohur si Monica Bellucci, Antonella Clerici, Diletta Leotta, Sabrina Salerno, Goergina Rodriguez, apo Mara Venier. "Kjo është ëndrra për të cilën ju kisha

folur! Ëndrra për të cilën kam punuar dhe besuar fort që 12 vjet. Ëndrra që frymëzoi festivalin e 58 të këngës! Italia që pas Shqipërisë sime është pa as më të voglin dyshim vendi më i bukur në botë. Trofeu im sot është trofe për të gjithë shqiptarët!", ka shkruar Alketa në "Instagram".

Lë të dashurin në "shtëpi", vajza e modelueses në plazh me dy djem



Ku është i dashuri i Kaia Gerber?! Vajza e modelueses së njohur Cindy Crawford është fotografuar duke shijuar rrezet e diellit në Miami, me dy djem, miq të saj, Antoni Porowski dhe Tommy Dorfman. Bukuroshja

18-vjeçare ka lënë vend për shumë diskutime kur nuk u pa dhe me partnerin, komedianin e SNL, Pete Davidson. Megjithatë, Kaia dukej se po kalonte një kohë të mirë teksa dukej tepër në formë e veshur me bikini të zeza.



Dua Lipa me "Don't Start Now" arrin 100 milionë klikime në 'YouTube'

Sukseset e këngëtares shqiptare me famë botërore Dua Lipa nuk kanë të ndalur. Këngëtarja sapo ka rritur 100 milionë klikime në 'YouTube' me këngën "Don't Start Now" të cilën e ka publikuar më 1 nëntor 2019. Këtë gjë e ka bërë me dije vetë Dua

nëpërmjet një postimi në "Instagram". "Kënga 'Don't Start Now' ka mbledhur 100 milionë shikime. Faleminderit shumë për dashurinë dhe mbështetjen! Duke dërguar dashuri gjithandej prej meje dhe Nabilido", ka shkruar në postimin e saj Lipa.

"ODA" nderon Capital T për solidaritetin pas tërmetit në Shqipëri

Reperi Capital T në mesin e trofeve që ka fituar tani e ka edhe një shumë të veçantë. Në pallatin presidencial në Tiranë, të martën u mbajt event "ODA", ku të pranishëm ishin shumë fytyra publike nga jeta politike dhe ajo e artit e muzikes shqiptare. Capital T

është nderuar me një trofe nga event i parvjetshëm "ODA", por që nuk ka të bëjë aspak me muzikën. Në këtë ngjarje reperi u nderua për kontributin humanitar që ka dhënë, duke iu dalë në ndihmë qytetarëve të prekur nga tërmeti në Shqipëri.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Hyseni: Ende nuk e di të ardhmen, oferta kam edhe nga Shqipëria

Sulmuesi Hasan Hyseni vazhdon të jetë i pavendosur për të ardhmen, pasi në njërën anë ka kontratë me klubin e Drenicës e në anën tjetër ka marrë disa oferta interesante në këtë afat kalimtar. "Oferta kam nga klubet e Kosovës, por edhe nga ato të Shqipërisë. Kontrata ime me Drenicën është edhe gjashtë muaj. Ende nuk kam marrë ndonjë vendim për të ardhmen, por besoj se brenda javës do të vendos se ku do të luaj në pranverë", ka thënë Hyseni

**EPOKA ERE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 15 JANAR - Futbollisti Hasan Hyseni ka kontratë me Klubin e Drenicës nga Skenderaj deri në fund të këtij kampionati, por ofertat që ka marrë në këtë afat kalimtar kanë bërë që ai të mendojë për ndryshim klubi. Hyseni për "Epokën e re" ka thënë se shumë shpejt do të marrë një vendim për të ardhmen, duke lënë të hapur të gjitha opsionet. "Oferta kam nga klubet e Kosovës, por edhe nga ato të Shqipërisë, derisa kontrata ime me Drenicën është edhe gjashtë muaj. Ende nuk kam marrë ndonjë vendim për të ardhmen, por besoj se brenda javës do të vendos se ku do të luaj në pranverë", ka thënë Hyseni, i cili nuk i ka bërë publike emrat e klubeve që e kanë kontaktuar në këtë afat kalimtar.

Hasan Hyseni nuk pati një edicion të mirë, pasi lëndimi ishte pengesë e tij. Ai është shprehur i lumtur se Klubi i Drenicës ka pasur rezultate të mira, derisa ka paralajmëruar se kuqezinjtë nga Skenderaj në pranverë do të jenë edhe më të fortë. "Në sezonin vjeshtor forma ime nuk ka qenë në nivelin e pritur për faktin se kam pësuar lëndim në miqësore dhe dy muaj kam qenë jashtë fushës, pra vështirë ka qenë ta kap menjëherë ritmin. Në anën tjetër Klubi i Drenicës ka pasur një sezon relativisht të mirë dhe se është brenda objektivit, kurse në pranverë kam besim se ky klub do të shfaqë lojërë edhe më të mira, por edhe pozita në renditjen tabelore do të jetë edhe më e mirë", ka shtuar Hyseni, i cili me sukses ka luajtur në të kaluarën për dy klubet e Mitrovicës, Trepçën dhe Trepçën '89. Klubi kuqez i në këtë afat kalimtar ka bërë disa ndryshime, në kryesi, shtab teknik e deri te futbollistët, kurse vlen të ceket

se trajnerin Tahir Lushtaku e ka zëvendësuar Gani Sejdiu. Drenica e përfundoi sezonin vjeshtor në pozitën e gjashtë me 24 pikë, ku nga 17 ndeshje të zhvilluara regjistroi 6 fitore, 6 barazime dhe 5 humbje.

Shala transferohet te Flamurtari

Futbollisti Bashkim Shala ka ndërruar të mërkurën klub. Ai edhe zyrtarisht është lojtar i KF Flamurtari nga Prishtina, kurse në sezonin vjeshtor ky futbollist e kishte djersitur fanellën e Vushtrrisë. "Tash e tutje jam pjesë e KF Flamurtari. Falënderoj për besimin e dhënë dhe shpresoj që së bashku t'i arrijmë ambiciet e klubit. Po ashtu, falënderoj tifozët 'Forca' për përkrahjen e vazhdueshme, kurse ish-Klubit FCVushtrria i dëshiroi suksese", ka shkruar Shala në "Facebook".

SHKURT

Drejtuesit e FFK-së vizitojnë portierin e diagnostikuar me tumor në lukth

Drejtuesit e Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, Xhelal Broja, Bakir Burri dhe Eroll Salihu, e kanë vizituar portierin e Trepçës '89, Arben Beqiri, i cili është diagnostikuar me tumor në lukth. "Ishte nder dhe kënaqësi vizita juaj në familjen time. Faleminderit për mbështetjen dhe gatishmërinë që treguat për mua në këto çaste. Vizita juaj është një frymëzim shtesë për mua që ta kaloj me sukses këtë sfidë", ka shkruar Beqiri në profilin e vet në "Facebook". Ndryshe të martën Shoqata për Mbrojtjen e të Drejtave të Futbollistëve të Kosovës ka marrë vendim që komuniteti sportiv nëpërmjet kësaj shoqate t'i dalë në ndihmë financiare portierit Arben Beqiri.

Ballkani vazhdon përgatitjet në Turqi

Kampioni vjeshtor i Kosovës në futboll, Ballkani, ka udhëtuar të mërkurën për Antalya të Turqisë ku do ta zhvillojë fazën përgatitore. Sipas njoftimit të klubit nga Suhareka, liderët e Superligës në Turqi pritet të qëndrojnë dhjetë ditë dhe atje do t'i zhvillojnë edhe katër ndeshje miqësore.

Përforcohet KB Rahoveci

KB Rahoveci ka konfirmuar se është përforcuar me amerikanin Aron Nwankwo. "Ish-anëtari i Kievit në Ukrainë dhe së fundi i Oliveirenses në Portugali, Nwankwo tash e tutje do ta djersitë fanellën e skuadrës nga 'Mizahir Isma'. 27-vjeçari amerikan është 203 centimetra, derisa luan në dy pozita specifike, por me theks të veçantë në alo-qendër. Ky është përforcimi i tretë brenda pak kohe, me bindjen e plotë se do të jetë i denjë për të na dërguar drejt titullit", thuhet në njoftimin e skuadrës së Rahovecit.

Loshaj prezantohet te Craiova

Florian Loshaj është prezantuar te klubi polak Craiova. Mesfushori nga Kosova nënshkroi kontratë trevjeçare me këtë klub kurse, së fundmi, Loshaj luajti te skuadra rumune FC Politehnica, derisa në stinorin vjeshtor u paraqit në 21 ndeshje, derisa mungoi një herë për shkak të kartonëve. Loshaj ka debutuar edhe për Përfaqësuesen A të Kosovës në miqësoren ndaj Suedisë.

Hashani, trajner i Vllaznisë

Erdin Hashani është emëruar trajner i ri i skuadrës së Vllaznisë nga Pozharani. Hashani në kohën kur ishte futbollist aktiv ishte pjesë e kësaj skuadre në Superligë. "Me inkuadrimitin e KF Vllaznia Pozheran në Superligën e Kosovës aty kishim nevojë për një lider dhe ishte e lehtë të përzgjidhet sepse Erdin Hashani iu bashkëngjiti ngjyrave të klubit tonë. Erdini përsëri kthehet në Pozheran, por kësaj radhe si udhëheqës i armatës sonë të lojtarëve. Na priftë e mbara kryetrajner", thuhet në njoftimin e klubit nga Pozharani.

Futbollisti Andi Kallaba shpallet mesfushori më i mirë në Illinois

CHICAGO, 15 JANAR - Futbollisti me prejardhje nga Kosova, Andi Kallaba, është shumë i njohur në Chicago, por tani edhe në

shtetin e Illinois. Në ceremoninë e nominimit të lojtarëve më të mirë për shkollat të mesme në shtetin e Illinois, Andi ishte i nominuar si mesfushori më i mirë në këtë ligë me 23 gola të shënuar si dhe 11 asistime. Pas këtij suksesi Andit i kanë ardhur shumë oferta

nga College të ndryshme nga D1. Ëndrra e Andi Kallabës është që një ditë ta përfaqësojë Shqipërinë ose Kosovën.



Astera Tuhina, shembulli për vajzat e reja të Kosovës

PRISHTINË, 15 JANAR - Vajzat që hezitojnë të merren me basketboll shembullin më të mirë e kanë Astera Tuhinën. Ajo është vetëm 15-vjeçare dhe luan në Spanjë, derisa gjithashtu është pjesë e Kosovës U16 dhe U20. Astera është një basketbolliste shumë e talentuar dhe shumë premtime për të ardhmen. Moshë nuk e ka penguar të arrijë suksese, derisa ka shumë synime për të ardhmen. Fillimisht ajo ka folur për sezonin e saj në Spanjë te skuadra e Prometes. "Edicioni i kaluar ishte i mrekullueshëm, sepse skuadra ku unë luaj është renditur në mesin e 16 skuadrave më të mira në Spanjë, prej më shumë se 3 000 skuadrave. Ky edicion deri më tani ka qenë shumë i mirë dhe shpresoj që si ekip të renditemi edhe më mirë se vitin e kaluar. Me paraqitjet personale jam shumë e kënaqur, mirëpo çdo ditë angazhohem më shumë dhe mundohem të kem paraqitje edhe më të mira. Këtë vit kam marrë pjesë edhe në 'përfaqësuesen' e komunës ku jetoj



dhe kemi pasur një sukses me vitin e kaluar", është shprehur Tuhina për faqen zyrtare të FBK-së. Ajo ka shtuar se ëndrra e saj e madhe është të luajë në WNBA, derisa gjithashtu nuk e harron edhe shkollimin. Ajo vitin e kaluar ishte pjesë e Kosovës U16 dhe U20, derisa me padurim po e pret verën e këtij viti për ta përfaqësuar sërish Kosovën në garat ndërkombëtare. "Jam e nderuar dhe privileguar që luaj për Kosovën dhe shpresoj se do

të kemi paraqitje sa më të mira". Në fund edhe mesazhi për vajzat e reja që duan të luajnë basketboll. "Besoj se çdo njeri duhet të merret me sport, çfarëdo qoftë ai, sepse për mua sporti është diçka që më ka ndihmuar shumë të kem një jetë më të shëndetshme, të krijoj shoqëri dhe të vizitoj shumë vende. Shpresoj se edhe vajzat e reja do të merren me basketboll dhe të kenë suksese në karrierën e tyre", përfundoi Astera Tuhina.

Houstoni bie ndaj Memphisit

MILWAUKEE, 15 JANAR - Edhe pse James Hardeni realizoi 41 pikë, skuadra e Houstonit nuk ka mundur ta mposhtë Memphisin që triumfoi me rezultat 121-110. Mungesa e Westbrookut u ndje te Houstoni, që humbet kontakt me kreun. Për Memphisin u dalluan Morant me 26 pikë e Brooksi me 24 pikë. Fitore ka arritur edhe Clippersi, që mundi me shifrat 128-103 Clevelandin, duke qëndruar në vendin e katërt në Perëndim. Ndashje e mirë e Kawhi Leonard, që realizoi 43 pikë. Humbasin edhe nënkampionët e Golden State, që u mundën 124-97 në fushën e tyre nga Dallasi. Powelli me 21 pikë e Donçiqi me 20 ishin më të mirë për Dallasin. Nuk zhgënjën ekipi i Milwaukee, që dominon renditjen në Lindje. Skuadra e Bucksit fitoi me rezultat 128-102 ndaj New



Yorkut, ndeshje ku u dallua Antetokounmpo, autor i 37 pikëve. Mirë po paraqitet skuadra e Utah Jazzit, që me fitoren ndaj Brooklynit (118-107) jashtë fushë është bërë forca e dytë në Konferencën e

Perëndimit. Për Jazzin u dalluan Inglesi me 27 pikë, Mitchell me 2 dhe Gobert me 22 pikë e 18 rebounde. Fiton edhe Atlanta, që mundi 123-110 Phoenix, me Trae Young që realizoi 36 pikë e 10 asistime.

REZULTATET

Atlanta - Phoenix	123-110
Brooklyn - Utah Jazz	107-118
Memphis - Houston	121-110
Milwaukee - New York	128-102
Golden State - Dallas	97-124
Golden State - Dallas	97-124
Clippers - Cleveland	128-103

SHKURT

Duka zgjedh kapiten Hysajn, Mavraj pajtohet me vendimin

Presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHF), Armand Duka, e ka zgjedhur një gazetë italiane për ta kumtuar vendimin që shiritin e kapitenit të ri të kuqezinjve tash e tutje do ta bartë Elseid Hysaj e jo Mërgim Mavraj. Në një deklaratë për "Gazzetta Dello Sport", Duka e ka graduar Hysajn kapiten të kuqezinjve. Përkundër kësaj, Mavraj ka treguar shpirt kapiteni. Nuk ka reaguar për hir të Kombëtares kur është kontaktuar nga "Panorama Sport". "Nuk kam asnjë reagim. Respektoj fjalët dhe vendimin e tij", është shprehur shkurtimisht qendërmbrojtësi shqiptar i cili nga viti 2012 luan për Shqipërinë dhe pas pensionimit të Lorik Canës ka pasur rast ta bartë shiritin e kapitenit, të cilin po ashtu e ka bartur edhe Ansi Agolli.

Kukësi: Daku u largua për shkak se kishte pak hapësira

Drejtori sportiv i Kukësit, Nderim Nexhipi, ka treguar se pse klubi e ka liruar Mirlind Dakun në janar. Ai theksoi që sulmuesi dështoi të gjejë hapësira në formacionin startues dhe për shkak se kërkonte minutazhë, Kukësi e liron. "Dakun e larguam pasi kishte pak hapësira dhe donte që të luante. Me largimin e këtij sulmuesi kemi një emër që mund ta afrojmë dhe zyrtarizojmë këto ditë, ndërsa në vendet e tjera nuk do të kemi ndërhyrje", u shpreh Nexhipi. Sulmuesi Daku u zyrtarizua te kampioni vjeshtor i Superligës së Kosovës, Ballkani.

Një ndeshje moslojë për Valverden

Federico Valverde u shpall MVP i Superkupës së Spanjës falë paraqitjeve mbresëlënëse në të dy ndeshjet (ndaj Valencias dhe Atletico) dhe një ndërhyrje në finale ndaj këtyre të fundit, e cila sa u lavdërua edhe u kritikua. Teksa po zhvilloheshin minutat e fundit të shtesës në finalen ndaj Atletico, mesfushori i Realit bëri një ndërhyrje ndaj Alvaro Moratas, i cili po dilte ballë për ballë me portierin Thibaut Courtois. Uruguaiiani u ndëshkua me karton të kuq, që pa dyshim ia vlejti - pasi në penallti triumfoi ekipi i tij. RFEF tashmë ka vendosur masat e dënimit për talentin e "Los Blancos". Valverde do t'i mungojë Realit vetëm një ndeshje në La Liga.

Tifozët zgjedhin formacionin e vitit 2019

UEFA ka publikuar ditën e sotme formacionin e vitit 2019, duke u bazuar në votat e tifozëve. Plot 2 milionë votues kanë zgjedhur formacionin e vitit, ku sistemi është 4-4-2 ose 4-2-4. Pa dyshim se Liverpoolsi është skuadra e cila ka më së shumti lojtarë në këtë formacion duke nisur nga porta me Alisson Becker. Më pas, në repartin mbrojtës gjenden Robertson, Van Dijk, De Lig dhe Alexander-Arnold, në mesfushë janë De Jong dhe De Jong, ndërsa sulmi përbëhet nga Mane, Lewandowski, Cristiano Ronaldo dhe Messi.

Messi: Me Ronaldon në Real, 'El Clasico'-t ishin të veçanta

Ylli i Barcelonës, Lionel Messi, beson se dueli i tij me Cristiano Ronaldon në La Liga ka qenë i veçantë dhe se do të mbetet përgjithmonë në mendjet e njerëzve, pavarësisht kalimit të tij në Serinë A. Me Messin në krye të Barcelonës dhe Ronaldos te Real Madridi nga viti 2009 deri në vitin 2018, dy yjet dominuan në futbollin botëror për t'i fituar të gjitha trofetë ekipore dhe individuale. "Ishte një duel i veçantë dhe do të mbetet përgjithmonë sepse zgjati shumë vite dhe nuk është e lehtë të ruash nivele të caktuara për një kohë të gjatë. Plus, skuadrat në të cilat kemi luajtur ishin gjithashtu shumë kërkuese, si Real Madridi ashtu edhe Barça, dy më të mirat në botë", ka thënë Messi. "Natyrisht kur Cristiano ishte në Real Madrid, ndeshjet 'El Clasico' ishin gjithmonë të veçanta. Ndashjet kundër Realit gjithmonë nënkuptojnë shumë, por kur Cristiano ishte aty ato u bënë shumë më të veçanta. Por, është një kohë që ka kaluar tani, që e kemi përjetuar. Tani duhet të shohim përpara për të ardhmen", ka shtuar Messi.



Infrastruktura Hekurudhave të Kosovës "INFRAKOS" Sh.A shpall:

KONKURS

POZITA: DREJTUES I LËVIZJES SË TRENAVE - PRAKTIKANT (6 pozita)

NJËSIA: Departamenti i Komunikacionit

KONTRATA: Me kohë të pacaktuar

I RAPORTON : Shefit të Stacionit

PËRGJEGJËSI MBIKËQYRËSI: JO

PËRSHKRIMI PUNËS:

- Është përgjegjës për sigurinë dhe rregullueshmërinë në komunikacionin hekurudhor
- Është përgjegjës për përgatitje të rregullt dhe nisje të trenave
- Është përgjegjës për sigurim të rrugëtimit të trenave në hyrje, dalje dhe kalim dhe për manipulim me sinjale kryesore sipas dokumentit teknik , dhe udhëzimeve teknike.
- Jep detyra , udhëheq dhe kontrollon realizimin e punëve manovruese.
- E kryen efektin e punës me trena të cilin ia dorëzon Dispeçerit të Komunikacionit.
- I udhëheq evidencat e nevojshme të komunikacionit dhe të vagonëve
- Është përgjegjës për realizimin e OLT-ës
- Kryen kontrollimin e rregullt dhe të jashtëzakonshëm të ndërrueseve.
- Është në kontakt të rregullt me Dispeçerin e komunikacionit
- E përcjellë lëvizjen e trenave
- E pajisë personelin e trenit me njoftime të nevojshme(Përmes Urdhërësës I dhe II)
- Pastron ndërrueset dhe zyrën në stacione pa ndërrues.
- Koordinon- kontakton me stacionet tjera në rregullimin e sigurt të lëvizjes së trenave
- Kryen edhe punë tjera sipas Urdhërësave-Udhëzimeve me karakter të përhershëm ose të përkohshëm dhe sipas detyrave të përcaktuara në dokumentin teknik të stacionit pjesa e I,II,dhe sipas Urdhrit të Shefit të stacionit
- Kujdeset për pronën brenda perimetrit të stacionit hekurudhor.
- Kujdeset për mirëmbajtjen e pastërtisë në objektet, stabilimentet (ndërruesve aty ku mungon ndërruesi, e te tjera) si dhe hapësirat brenda dhe rreth stacionit.

KUSHTET, AFTËSITË DHE NJOHURITË E KËRKUARA:

- Teknik i lëvizjes së trenave
- Të jetë i aftë në zgjidhjen e problemeve
- Të ketë aftësi organizative, planifikuese dhe orientim të qartë
- Të ketë grupen e parë shëndetsore
- Të njeh shumë mirë gjuhën shqipe, serbe dhe e dëshirueshme njohja e ndonjë gjuhe tjetër.
- Të njeh shumë mirë punën me kompjuter

POZITA: NDËRRUES I BINARËVE – PRAKTIKANT (9 pozita)

NJËSIA: Departamenti i Komunikacionit

KONTRATA: Me kohë të pacaktuar

I RAPORTON : Shefit të Stacionit

PËRGJEGJËSI MBIKËQYRËSI: JO

PËRSHKRIMI PUNËS:

- Është përgjegjës për sigurinë dhe rregullimin e komunikacionit hekurudhor.
- Mbiqyrë dhe përgjigjet për drejtvendosjen e ndërruesve dhe që binari dhe sinori të jenë të lirë.
- Përgjigjet për sigurinë e komunikacionit të trenave gjatë manovrimit në stacion.
- Lajmëron me kohë krye manovruesin që me kohë të ndalë manovrimin për hyrje-dalje ose kalim të trenave.
- Në stacionin e F.Kosovës ne bl. II përgjigjet për siguri dhe manipulim të aparatit për vendkalim.
- Në stacionin e Pejës bën sigurimin e vendkalimit për hyrje dhe dalje të gjithë trenave
- Udhëheq evidencat e nevojshme sipas rregullativave të aplikueshme.
- Pastron dhe i mirëmban ndërrueset dhe pajisjet tjera.
- Kujdeset për pronën brenda perimetrit të stacionit hekurudhor.
- Kujdeset për mirëmbajtjen e pastërtisë në objektet, stabilimentet, si dhe hapësirat brenda dhe rreth stacionit.
- Kryen edhe punë tjera sipas dokumentit teknik të stacionit urdhrit të drejtuesit të trenave dhe shefit të stacionit.
- Kryen edhe pune tjera sipas kërkesës së mbikëqyrësit.

KUSHTET, AFTËSITË DHE NJOHURITË E KËRKUARA:

- Shkolla e mesme.
- 1 vjet përvojë.
- Gjendje të mirë shëndetsore
- Të njeh shumë mirë gjuhën shqipe

POZITA: Zyrtar ligjor (1 pozitë)

NJËSIA: Zyrtar ligjor

KONTRATA: Me kohë të pacaktuar

I RAPORTON : Mbikëqyrësit të zyrës ligjore

PËRGJEGJËSI MBIKËQYRËSI : Jo

PËRSHKRIMI I PUNËS:

- Asiston në përpilimin e Rregulloreve dhe akteve tjera të kompanisë
- Përfaqëson Infracos Sh.A pranë gjykatave në tërë territorin e Kosovës
- Inicon procedurën gjyqësore në gjykata
- Ushtron padi, ankesa, kundërshtime, parashtrita etj
- Bënë ekzekutimin e aktgjykimeve dhe aktvendimeve që kanë formën e prerë
- Në raste të caktuara përfaqëson Infracos Sh.A edhe në kontestet tjera
- Administron me lëndët që janë në procedurën gjyqësore dhe kanë marrë formën e prerë
- Kryen edhe detyra tjera sipas kërkesës së mbikëqyrësit

KUSHTET, AFTËSITË DHE NJOHURITË E KËRKUARA:

- Jurist i diplomuar
- Provimi i jurisprudencës i dëshirueshëm
- Minimum dy vjet përvojë punë në profesion
- Njohuri të ligjeve dhe procedurave gjyqësore dhe njohuri mbi përpilimin e rregulloreve dhe akteve normative
- Aftësi për të punuar nën presion dhe përfundim të punëve me afat
- Aftësi për përdorim të kompjuterit MS Windows dhe MS Office
- Aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit në gjuhën shqipe
- E dëshirueshme njohja e gjuhës serbe dhe angleze

POZITA: Ekonomist i diplomuar praktikant

NJËSIA: Përcaktohet pas përfundimit të stazhit të praktikantit

KONTRATA: Praktikant

I RAPORTON : Mbikëqyrësit

PËRGJEGJËSI MBIKËQYRËSI : Jo

KUSHTET, AFTËSITË DHE NJOHURITË E KËRKUARA:

- Ekonomist i diplomuar
- Aftësi të shkëlqyeshme organizative.
- Shkathësi të mira nder personale dhe komunikative.
- Nivel të lartë të integritetit, iniciativë dhe aftësi për të punuar nën presion.
- Njohuri të mira kompjuterike dhe programeve të tyre si: MS Word, MS Excel, Internet.
- Njohja e gjuhëve: Shqipe, Serbe, njohja e gj. angleze e dëshirueshme

PROCEDURA E APLIKIMIT:

Aplikacioni dhe konkursi mund të merren në ndërtesën e drejtorisë në Fushë Kosovë. Aplikacioni së bashku me dëshmitë tjera mund të dorëzohet në ndërtesën e drejtorisë së Infracos, në adresën Sheshi i Lirisë pn, në Fushë Kosovë. Dokumentet duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur në të cilën duhet të shkruhet pozita për të cilën aplikon. Data e fundit për aplikim është më datë: **30/01/2020 ora 16:00**. Dokumentacioni që mbërrin pas ketij afati dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm. Dokumentet duhet të dorëzohen vetëm në kopje pasi të njëjtat nuk ju kthehen.

Për informata të tjera na kontaktoni në numrin e tel. 038 550 550 237.


Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898


Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas
Municipality
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM



Nr.13/33
Më: 15/01/2020
D r a g a s h

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit mbi Punën në Republikën e Kosovës, nr.03/L-212, nenit 5 të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.10/2018 të datës 20.07.2018 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ nr.05/2015- normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, vendimin e MASHT nr.232/01B, vendimin e MASHT nr.231/01B të datës, 04 Gusht 2015, kërkesën nga MASHT ref.2-2955 të datës 01 Korrik 2016. Drejtoria Komunale për Arsim në Dragash, shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për arsimin parafillor, fillor të mesëm të ulët të Komunës së Dragashit për vitin shkollor 2019/2020.

SHFMU " Imi Bahtjari"- Blaç

- Një edukatore për mësimin parafillor në paralelen e ndarë në Zgatar
- Një mësimdhënës për Gjuhë Shqipe (12 orë)

SHFMU "Ulina" –Kosavë

- Një mësimdhënës për mësim klasor (deri sa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë)

SHFMU "Fetah Sylejmani" Dragash

- Një mësimdhënës për mësim klasor – Xërrxe

SHFMU " Sezai Surroi"- Bellobrad

- Një edukatore për mësimin parafillor në paralelen e ndarë në Zym (deri sa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë)
- Një mësimdhënës për Gjuhë Gjermane (10 orë)

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:
Formulari i aplikimit (merret në DKA ku dorëzohen aplikacionet me dokumentet tjera përkatëse.), Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit ose pasaportës), Diploma duhet të jetë e vërtetuar nga origjinali, në të kundërtën nuk merret si valide (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara te noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj. Kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Kosovës, duhet të sjellin diplomën e nostrifikuar, Certifikata që nuk jeni nën hetime, Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).
Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** nga data e publikimit në mjetet e informimit.
Vërejtje: Dokumentacioni i kompletuar për konkurrim nuk iu kthehet kandidatëve.

Datë:15.01.2020
Dragash

Drejtori i DKA-së
MSc. Vloran Cenaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIA E ARSIMIT

Nr-4-111 - 2890
Datë: 15.01.2020

Në bazë të nenit 16 dhe 62 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/040, Ligjit të punës Nr 03/L-212, Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068, neni 5 pika C, Statutit të Komunës së Lipjanit, U.A Nr.10/2018 (MASHT) dhe U.A Nr.07/2017 (MPMS), Drejtoria Komunale e Arsimit në Lipjan rishpall:

KONKURS
Për plotësimin e vendeve të punës

I. SHFMU "Shtjefën Gjeçovi" në Janjevë, p.n.f Brus

- Një (1) Arsimtar/e për Fizikë (8 orë) (deri më 30 qershor)
- Një (1) Arsimtar/e për Tik (5 orë) (deri më 30 qershor)

Kushtet e kërkuara:

- Përgatitje adekuate profesionale, në bazë të normativit 10/2018 (MASHT),
- Diplomë (Certifikatë) fotokopje të vërtetuar nga organi përkatës (në formatin A4),
- Certifikata e lindjes,
- Letërnjoftimi – fotokopje,
- Dëshmi se nuk jeni nën hetime.

Dokumentet e pranuar nuk kthehen.

Njoftim:
Informimi i kandidatëve aplikues rreth mbajtjes së testit me shkrim, intervistës me gojë dhe shpallja e rezultateve do të bëhen në Web faqen e Komunës <https://kk.rks-gov.net/lipjan/> dhe në tabelën e shpalljeve.

Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbime me Qytetar në Komunë në sportelet Nr.1-2 dhe dorëzohen në të njëjtën vend, bashkë me dokumentet për konkurim. Aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen. Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik.

Drejtoresha e DKA-së
Elmaze Behluli



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, kompania "Valdrini-A" Sh.p.k Kramovik, Rahovec, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:


DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për eksploatimin e gurit gëlqeror në lokacionin "Shume Kabilje Glava" komuna e Rahovecit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 11.02.2020 në ora 11:00 në hapësirat e restorant "Bjeshka" i cili gjendet në magjistralen Malishevë-Rahovec, do të organizohet debat publik nga kompania "Valdrini-A" Sh.p.k Kramovik, Rahovec, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për eksploatimin e gurit gëlqeror në lokacionin "Shume Kabilje Glava" komuna e Rahovecit.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA
QENDRA KRYESORE E MIJEKËSISË FAMILJARE
MAIN FAMILY MEDICAL CENTRE
"DR. SHPEJTIM ROBAJ"
MALISHEVË

Nr. 14
Data: 15.01.2020

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
KUVENDI KOMUNAL -MALISHEVË

Drejtori i QKMF-së "Dr. Shpëtim Robaj" në Malishevë, në bazë të Rekomandimit nr.07/08 dhe 07/09 të dt.14.01.2020 të drejtoratit të Shëndetësisë dhe MS në Malishevë, Drejtoria e QKMF-së në bazë të nenit 8 të ligjit të punës nr.03/L-212 si dhe nenit 4 të udhëzimit administrative nr.7/2017, për rregullimin e procedurave për konkurs në sektorin publik, për plotësimin e vendeve të punës publikon këtë:

KONKURS PUBLIK
Për praninë të dy punëtorëve:

I. TITULLI I VENDITTE PUNES – ZYRTAR I PËRSONELIT NË QKMF, NJË(1) POZIT
II. INFIERMIER I PËRGJITHSHE MEDICINAL NË QKMF,QMF dhe AMF. NJË (1). POZIT.

Detyrat dhe përgjegjësit;
Punët dhe detyrat e punës të kryhen në bazë të përshkrimit të detyrave të punës së zyrtari të personelit të paraparë sipas Rregullores mbi sistematizimin dhe organizimin e brendshëm të institucionit si dhe punët tjera nga lemia e tij përkatëse sipas urdhrit të shefit dhe drejtorit.

Detyrat e punës së Infermierit të përgjithshëm:
Ofron shërbime shëndetësore nga lëmia e mjekësisë familjare në QKMF,QMF dhe AMF. Siguron shërbime shëndetësore për të gjithë qytetaret pa dallim:kombi ,etnie ,feje ,race, gjinie. Jep inekcione,infuzione,pastron plagë të pacienteve,vaksinon femijet, kryen edhe shërbimet të tjera sipas ligjit të shëndetësisë .

Kushtet e veqanta te konkursit:

- Per Zyrtar Personelit :Fakulteti Juridik. Me koficient 7.2 H.30
- Pervoj pune profesionale 3 vite dhe njohuri te shkelqyshme te programeve Microsoft office.
- Për Infermier të përgjithshëm me koficient 4.8 H.68.
- Diplomae shkolles së mesme medicinale ,Licencen e punës.
- Kushtet e përgjithshme:Certifikaten e lindjes,-Certifikaten që nuk është nën hetime ose i denuar.
- Certifikaten e mjekut për punë.,Leternjoftimin e fotokopjuar .
- Kohëzgjatja kontratës: në kohë të pa caktuar (pas përiudhës provuese tremujore).
- Orët javore të punës 40.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mjete te informimit , aplikacionet e arritura pas afatit nuk pranohen , aplikacionet me dokumenta të pa kompletuara nuk shqyrtohen. dokumentacioni dorëzohet në zyrën e personelit të QKMF-së.

Drejtori
Dr.Nuhi Morina -sp.Pediatrer



Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjeipuneshpeite

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Ilaz Zena shpall të pavlefshme dëftesën e SHF nga I deri VIII "Emin Duraku" Likoc.

► Salim Curri Shpalle te pavlefshme diplomën e Sh.M.L "Dardania" Hani Elezit.

► Zemile Berisha shpalle te pavlefshme dëftesën e Kl 1-8 Shkolla Fillore "Veli Ballazhi" Hani Elezit.

► Fatmire Cecelia shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Dr. Xheladin Deda" - Mitrovicë.

► Jetmir Ramadani shpall të pavlefshme dëftesën e SHF "Dëshmorët e Qyqavicës" Qirez.

► Ardian Halili shpall të pavlefshme dëftesat e klasës së dhjetë, njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë si dhe diplomën dhe certifikatën e shkollës së mesme "Gjin Gazulli" Prishtinë.

► Shkëlzen Llugaliu shpall të pavlefshme dëftesat e klasës së dhjetë, njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë, trembëdhjetë si dhe diplomën e shkollës së mesme "7 Shtatori" Prishtinë.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistranja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare.
Tel. 044-413-197.



Kolegji ILIRIA në Prishtinë, me rastin e shënimit të **552-vjetorit** të vdekjes së heroit kombëtar shqiptar **Gjergj Kastrioti Skënderbeu**, organizon simpoziumin shkencor me titull:

**GJERGJ KASTRIOTI SKËNDERBEU
NË DOKUMENTE TË PANJOHURA ARKIVORE
TË VENDEVE TË HUAJA**

SIMPOZIUM SHKENCOR

**FTESË PËR SIMPOZIUM SHKENCOR,
GJERGJ KASTRIOTI -SKENDERBEU, NË GRAND
HOTEL NË PRISHTINË MË 17 JANAR 2020 ORA
12.00 SALLA SOLEMNE-KATI I PARË!
ORGANIZUAR NGA KOLEGJI "ILIRIA" NË SHËNIM
TË 552 VJETORIT TË VDEKJËS SË TIJ!**

Simpoziumi do të mbahet më
17 janar 2020
në sallën solemne të
"Grand Hotel"-it në Prishtinë,
Kati I, në orën 12.00